



RAPORT VJETOR

**MBI VEPRIMTARINË
E KUVENDIT TË SHQIPËRISË**
për vitin 2016



**RAPORT VJETOR
MBI VEPRIMTARINË
E KUVENDIT TË SHQIPËRISË
për vitin 2016**

Tiranë, 2017



PËRMBAJTJA

Hyrje	7
Kapitulli 1	
Veprimtaria ligjvënëse	9
Kapitulli 2	
Kontrolli parlamentar	18
Kapitulli 3	
Funksioni zgjedhës	23
Kapitulli 4	
Veprimtaria e organeve të Kuvendit	26
Kapitulli 5	
Veprimtaria ndërkombëtare	28
Kapitulli 6	
Transparenca parlamentare	36
Kapitulli 7	
Administrimi	44
Përfundime	55





HYRJE

Gjatë vitit 2016 veprimtaria e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është fokusuar në adresimin e rekomandimeve të raportit të Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2015, të cilat lidhen edhe me kushtet për hapjen e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin European. Kështu, Kuvendi ka miratuar me unanimitet amendimet kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi, duke përmbyshur një nga detyrimet kryesore që Shqipëria ka në këtë fazë të procesit të integrimit në BE; ka miratuar me konsensus kuadrin e nevojshëm ligjor dhe nënligjor për adresimin e çështjes së individëve me rekorde kriminale që mbajnë një post publik ose kërkojnë të zgjidhen apo të emërohen në një post të tillë; ka filluar dhe vijon punën për reformën zgjedhore, si dhe ka forcuar më tej rolin e tij në procesin e integrimit european.

Kuvendi ka miratuar me unanimitet amendimet kushtetuese që synojnë reformimin e institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë në Shqipëri në përputhje të plotë me praktikën më të mira dhe standardet më të larta ndërkombëtare në këtë fushë. Këto amendime sjellin ndryshime të rëndësishme në mënyrën e organizimit të organeve të sistemit të drejtësisë dhe kompetencat përkatëse të tyre, duke parashikuar mekanizma konkretë, që do të rritin përgjegjshmërinë, profesionalizmin dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë, si dhe parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit brenda tij. Krahas amendamenteve kushtetuese Kuvendi i Shqipërisë miratoi 7 projektligjet prioritarë që shoqërojnë projektin kushtetues, që bëjnë të mundur zbatimin e tij. Paralelisht ka vijuar puna dhe për hartimin dhe shqyrtimin e paketës prej 27 projektligjesh në reflektim të ndryshimeve kushtetuese dhe 7 ligjeve prioritarë dhe që do t'i shërbejnë implementimit të plotë të reformës në sistemin e drejtësisë në këndvështrimin procedural dhe teknik.

Kuvendi ka miratuar me konsensus ndryshimet në kuadrin rregullator për adresimin e çështjes së individëve me rekorde kriminale që mbajnë një post publik ose kërkojnë të zgjidhen apo të emërohen në një post të tillë. Miratimi i këtyre ndryshimeve në nivel kushtetues dhe ligjor synon të rrisë besimin e qytetarëve shqiptarë të përfaqësuesit e tyre politikë dhe institucionet publike si dhe zbatimin e kuadrit ligjor të miratuar më parë. Tashmë Kuvendi si dhe institucionet e tjera janë në fazën e zbatimit të këtij kuadri ligjor për personat zyrtarë përgjegjës.

Gjatë vitit 2016 ka vijuar punën Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore. Pranë këtij komisioni janë paraqitur propozime për ndryshime në Kodin Zgjedhor të disa subjekteve, propozime të ekspertëve të BE-së për përmirësimin e kuadrit ligjor lidhur me financimin e partive politike gjatë procesit zgjedhor, të cilat janë në diskutim pranë këtij Komisioni, sikundër dhe propozimet rreth mënyrës së realizimit të procesit zgjedhor.

Roli kontrollues i Kuvendit në procesin e integrimit european është forcuar më tej me ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Integrimit European, si institucioni më i lartë koordinues kombëtar për integrimin european.



Kuvendi i Shqipërisë organizoi për herë të parë që prej anëtarësimit të Shqipërisë në NATO (1 prill 2009) Sesionin e Pranverës të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, e cila u zhvillua në Tiranë nga data 27 deri më 30 maj 2016.

Gjithashtu gjatë vitit 2016 përpjekje të rëndësishme janë bërë për rritjen e transparencës parlamentare, nxitjen dhe promovimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Raporti vjetor i Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2016 synon të japë një panoramë analitike të punës së bërë gjatë kësaj periudhe përmes 7 kapitujve përbërës, të hartuar nga shërbimet e Kuvendit sipas specifikave dhe fushës që mbulojnë.



Kapitulli 1

VEPRIMTARIA LIGJVËNËSE

1.1. Kuvendi në seancë plenare

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2016 aktiviteti parlamentar është zhvilluar në 46 seanca plenare me një shtrirje kohore prej 371 orësh¹.



Kuvendi i Shqipërisë ka ushtruar funksionet e tij në dy sesione të zakonshme: sesioni VI (janar–korrik 2016), sesioni VII (shtator–dhjetor 2016) dhe një sesion të jashtëzakonshëm (30 gusht 2016). Sesioni i jashtëzakonshëm u mbledh me kërkesë të jo më pak se 1/5-s së deputetëve për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë vitit 2016 Kuvendi ka miratuar 260 akte.

Nga këto:

- 142 ligje;
- 98 vendime;
- 20 rezoluta.

Janë bërë 1248 diskutime në 270 orë debat parlamentar².

Nga këto:

- shumica parlamentare ka bërë 670 diskutime në 118 orë;
- pakica parlamentare ka bërë 578 diskutime në 108 orë³.

¹. Në vitin 2015 janë zhvilluar 44 seanca me kohëzgjatje 352 orë.

². Në vitin 2015 janë bërë 1488 diskutime në 270 orë debat parlamentar.

³. Në vitin 2015 mazhoranca ka bërë 753 diskutime në 137 orë debat, ndërsa opozita 735 diskutime në 144 orë debat.



Krahasuar me vitin 2015 rezulton se numri i ligjeve të miratuara në vitin 2016 është **13 më i ulët**, ndërsa numri i vendimeve është **rreth 12 më i ulët**.

Gjatë vitit 2016 në Kuvend janë depozituar 183 nisma ligjvënëse⁴.

Nga këto:

- 127 nga Këshilli i Ministrave;
- 56 nga deputetë.



E shprehur në përqindje, 69% e nismave ligjvënëse kanë qenë nisma të Këshillit të Ministrave, ndërsa 31% nisma të deputetëve.

Ndërkohë janë depozituar 125 projektvendime dhe projektrezoluta.

Nga viti 2015 janë mbartur në vitin 2016 për shqyrtim dhe miratim 33 projektligje, 2 projektvendime, 2 akte normative dhe 1 dekret për rishqyrtim ligji.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar rezulton se në vitin 2016 Këshilli i Ministrave ka depozituar në Kuvend 31 projektligje më pak, ndërsa nga deputetët janë depozituar 29 nisma ligjvënëse më shumë.

Funksioni ligjvënës ka konsistuar në miratimin e 142 ligjeve, nga të cilat:

- 45 prej tyre janë ratifikime marrëveshjesh ndërkombëtare apo aderime në konventa të ndryshme;
- 3 akte normative me fuqinë e ligjit;
- 126 nisma të Këshillit të Ministrave;
- 16 nisma deputetësh.

Nga këto:

- 1 nismë është miratuar me shumicë të cilësuar prej 2/3-at e të gjithë anëtarëve të Kuvendit;
- 13 nisma janë miratuar me shumicë të cilësuar prej 3/5-at të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Opozita parlamentare ka dhënë konsensusin e saj për miratimin e 33 ligjeve⁵.

5 projektligje rezultojnë të jetë tërhequr nga nismëtari (KM), ndërkohë që projektligje/nisma të tjera vijnë të jenë në procedurë parlamentare, duke u mbartur në programe dhe kalendarë pune.

❖ **Ligje të shqyrtuara dhe të miratuara me procedurë të përshpejtuar⁶**

Gjatë vitit 2016 Kuvendi ka miratuar me procedurë të përshpejtuar 7 projektligje.

⁴. Në vitin 2015 janë depozituar 185 projektligje: 158 nga KM dhe 27 nga deputetë

⁵. Në vitin 2015 opozita ka dhënë konsensusin e saj për miratimin e 56 ligjeve.

⁶. Në vitin 2015 procedura e përshpejtuar është ushtruar në shqyrtimin e 10 projektligjeve.



Nga këto:

- 5 projektligje me kërkesë të Këshillit të Ministrave;
- 2 projektligje me kërkesë të 1/5-s së deputetëve.

❖ **Projektligje të shqyrtuara në seancë plenare në bazë të kërkesës për ndryshimin e rendit të ditës**

Gjatë vitit 2016 Kuvendi ka shqyrtuar dhe miratuar 4 projektligje me kërkesë për ndryshimin e rendit të ditës.

❖ **Ligje të kthyera për rishqyrtim⁷**

Gjatë vitit 2016 Presidenti i Republikës ka ushtruar të drejtën e vetos për kthimin edhe një herë në Kuvend për rishqyrtim për 6 ligje.

Kuvendi ka pranuar dekretin e Presidentit për vendimin e mëposhtëm:

- Vendim nr. 63/2016 “Për miratimin e dekretit nr. 9501, datë 4.04.2016 të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 19/2016 ‘Për masat shtesë të sigurisë publike’»”.

Në procedurë parlamentare është shqyrtimi i 2 dekreteve të mëposhtme:

- Dekreti nr. 9765, datë 14.10.2016 “Për kthimin e ligjit nr. 92/2016 «Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, ‘Për menaxhimin e integruar të mbetjeve’, i ndryshuar»”;
- Dekret me nr. 7969, datë 18.10.2016, “Për kthimin e ligjit nr. 93/2016 «Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9640, datë 9.11.2006, ‘Për dhomat e tregtisë dhe industrisë’, i ndryshuar»”.

❖ **Nisma ligjvënëse të tërhequra nga nismëtari⁸**

Gjatë vitit 2016 janë tërhequr nga nismëtari 5 projektligje:

- 4 nga Këshilli i Ministrave;
- 1 nga deputet nismëtar.

❖ **Nisma ligjvënëse të pamiratuara (të rrëzuara në parim)⁹**

Gjatë vitit 2016 janë dy nisma ligjvënëse që janë shqyrtuar nga komisionet parlamentare dhe për të cilat është propozuar mosmiratimi i tyre në seancë plenare nga Kuvendi.

❖ **Programet dhe kalendarët e punës së Kuvendit për vitin 2016**

Gjatë vitit 2016 Kuvendi e ka planifikuar veprimtarinë e vet në 8 programe dhe në 16 kalendarë pune, si mekanizma proceduralë kushtetues që ndihmojnë për shqyrtimin dhe miratimin e akteve juridike.

⁷. Në vitin 2015 ka pasur 6 raste të kthimit të ligjit nga Presidenti i Republikës për rishqyrtim në Kuvend.

⁸. Për vitin 2015 numërohen 4 projektligje të tërhequra nga nismëtari.

⁹. Për vitin 2015 numërohen 4 projektligje të rrëzuara në parim.




❖ Çështjet e futura automatikisht në programin e punës së Kuvendit për shqyrtim

Gjatë vitit 2016 janë 21 akte dhe nisma ligjvënëse me karakter financiar apo dekrete që janë futur automatikisht në programin e punës së Kuvendit për shqyrtim. Ato paraqiten si më poshtë:

- Në programin e punës për periudhën 11 prill–20 maj 2016 janë futur 4 akte.
- Në programin e punës për periudhën 23 maj–1 korrik 2016 janë futur 4 nisma.
- Në programin e punës për periudhën 5 shtator–14 tetor 2016 janë futur 3 akte.
- Në programin e punës për periudhën 17 tetor–25 nëntor 2016 janë futur 3 akte.
- Në programin e punës për periudhën 30 nëntor–24 dhjetor 2016 janë futur 7 nisma.


1.2. Veprimtaria e komisioneve të përhershme parlamentare

Komisionet e përhershme parlamentare kanë shqyrtuar dhe miratuar 378 projektakte ligjore, konkretisht: 206 nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues dhe propozimin e nismave të reja ligjore; 146 marrëveshje ndërkombëtare; 14 projektrezoluta, 6 projektvendime, 3 akte normative dhe 3 dekrete. E gjithë veprimtaria parlamentare në komisionet e përhershme dhe nënkomisionet është realizuar me organizimin e 482 mbledhjeve, të cilat kanë pasur një kohëzgjatje prej 451 orë.



Numri i mbledhjeve të komisioneve parlamentare gjatë vitit 2015 dhe 2016

Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së komisioneve të përhershme dhe nënkomisioneve ka qenë edhe organizimi i 232 seancave dëgjimore: 133 për procesin legjislativ, 18 për procesin zgjedhës dhe 60 për kontrollin parlamentar. Në përfundim të shqyrtimit të nismave ligjore komisionet e përhershme kanë miratuar 1163 amendamente, të cilat ia kanë paraqitur për shqyrtim dhe miratim seancës plenare.



Seancat dëgjimore gjatë kontrollit parlamentar sipas komisioneve gjatë vitit 2015 dhe 2016

Në mbështetje të veprimtarisë legjislative të Kuvendit funksionojnë Shërbimi i Seancës Plenare, Shërbimi Juridik dhe Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit (SHPL).

Shërbimi i Seancës Plenare e ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për nëpunësin civil, Rregulloren e Kuvendit, rregulloren e administratës së Kuvendit, *Manualin e përshkrimit të punëve në administratën e Kuvendit* si dhe rregulloret e urdhrat e nxjerra nga Sekretari i Përgjithshëm.

❖ **Shërbimi i Seancës Plenare gjatë vitit 2016 ka përgatitur për Kryetarin e Kuvendit dhe Konferencën e Kryetarëve opinionet¹⁰** lidhur me çështjet procedurale të kërkuara nga grupet parlamentare lidhur me zgjatje afati komisioni hetimor, kërkesë për ngritje komisioni hetimor, kërkesë për ndryshimin e rendit të ditës, kërkesë për miratimin me procedurë të përshpejtuar, miratim projektrezolutash, përfshirje aktesh në program dhe kalendar, kërkesa me objekt për konstatim për mbarimin e mandatit të deputetëve, për shpërndarjen e deputetëve në komisionet parlamentare, kërkesa për zhvillim referendumi etj.

❖ **Shërbimi i Seancës Plenare gjatë vitit 2016 ka përgatitur për Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin memo¹¹** dhe raporte lidhur me aspektin juridik të projektvendimit për zbatimin e ligjit nr. 138/2015, kërkesën për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kërkesë për interpretimin e Rregullores, raporte për çështje të verifikimit të mandateve të deputetëve të rinj etj.

❖ **Shërbimi i Seancës Plenare gjatë vitit 2016 ka konceptuar për Kryetarin e Kuvendit urdhrat për mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare¹², për mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve¹³,**

¹⁰. Janë përgatitur të paktën 20 memo.

¹¹. Janë përgatitur 9 memo dhe raporte.

¹². Janë hartuar 46 urdhra për mbledhjen e seancës plenare.

¹³. Janë hartuar 26 urdhra për mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve.



për mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin¹⁴, si dhe ka hartuar dhe publikuar vendimet e Konferencës së Kryetarëve për çështje të ndryshme të rendit të ditës¹⁵.

❖ **Shërbimi i Seancës Plenare gjatë vitit 2016** ka përgatitur për Kryetarin e Kuvendit 8 projektprograme, 16 projektkalendarë të punimeve të Kuvendit dhe 45 rende dite, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit.

❖ **Shërbimi i Seancës Plenare gjatë vitit 2016** ka publikuar (në PDF) në faqen zyrtare të Kuvendit, në internet, dokumentacionin parlamentar të mëposhtëm:

- 183 projektligje, 183 relacione shoqëruese, 47 tabela, 51 anekse, 52 marrëveshje ndërkombëtare dhe 142 ligje të miratuara (*publikuar në dy kategori*);
- 142 fletë votimi në tërësi të projektligjeve të miratuara;
- 124 projektvendime, 29 relacione shoqëruese të projektvendimeve, 7 anekse të projektvendimeve dhe 98 vendime (*publikuar në kategori*);
- 3 raporte të projektvendimeve dhe 47 fletë votimi të projektvendimeve;
- 20 projektrezoluta dhe 13 fletë votimi të projektrezolutave;
- 8 programe pune të Kuvendit;
- 16 kalendarë trejavorë të punimeve të Kuvendit;
- 46 rende dite të seancave plenare, 46 urdhra të Kryetarit të Kuvendit për mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare dhe 43 fletë votimi për verifikimin e kuorumit të seancës plenare;
- 6 dekrete të Presidentit të Republikës për kthimin e ligjeve të miratuara për rishqyrtim;
- 4 fletë votimi për dekretet e Presidentit të Republikës për ligjet e kthyera në Kuvend;
- 20 rezoluta (*publikuar në dy kategori*) dhe 18 raporte të organeve kushtetuese/të krijuara me ligj;
- 4 amendamente 24 orë përpara seancës plenare;
- ndryshimet në përbërjet e strukturave parlamentare dhe përbërjet e organeve të Kuvendit;
- 4 krijime të strukturave të reja (komisione hetimore)
- 23 procesverbale të Konferencës së Kryetarëve, 4 procesverbale të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe 5 procesverbale të Këshillit Kombëtar të Integritetit Europian;
- 2 kërkesa për interpelancë dhe 72 kërkesa për informacion;
- kryesitë e grupeve parlamentare, deputetët sipas qarqeve, deputetët sipas grupeve parlamentare, deputetët dhe planvendosjen në sallë të deputetëve;
- Aleanca e Grave Deputete;
- Aktet normative (*përditësim në faqe*);
- 16 lista të diskutuesve në seancë plenare dhe 4 tabela si kanë votuar deputetët në periudhën shtator–dhjetor.

❖ **Shërbimi i Seancës Plenare gjatë vitit 2016** ka hartuar 48 projektvendime për çështje të ndryshme, si: ndryshime në përbërjet e strukturave parlamentare, dërgim të çështjes në Gjykatën Kushtetuese për të konstatuar papajtueshmërinë me mandatin e deputetit, ngritje komisionesh hetimore, miratime të programeve të punës dhe kalendarëve trejavorë në seancë plenare, ndryshim i rendit të ditës etj.

❖ **Shërbimi Seancës Plenare gjatë vitit 2016** ka zbardhur 208 faqe procesverbale të mbledhjeve të Konferencës së Kryetarëve dhe të këshillave.

¹⁴. Janë hartuar 7 urdhra për mbledhjen e Këshillit.

¹⁵. Janë hartuar 20 vendime të Konferencës së Kryetarëve.



❖ **Shërbimi i Seancës Plenare gjatë vitit 2016**, bazuar në urdhrin e Sekretares së Përgjithshme nr. 93, datë 29.04.2016 “Për miratimin e rregullave të detajuara për mirëfunksionimin e zyrës së shumëfishimit” ka filluar zbatimin e urdhrit dhe ka dorëzuar raportime mujore për periudhën prill–dhjetor 2016 për fotokopjet në selinë e Kuvendit dhe atë të sallës së seancave plenare.

❖ **Shërbimi i Seancës Plenare gjatë vitit 2016** është angazhuar edhe me implementimin e plotë të platformës *e-parlament*, në të cilën Shërbimi ynë ka kryer me sukses fazën e parë të testimit, si dhe ka paraqitur ndryshimet mbi disa çështje që dolën pas testimit.

Konkretisht Shërbimi i Seancës ka realizuar hapat e mëposhtëm:

- hartimin e projektprogramit të punimeve të Kuvendit;
- krijimin e mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve;
- hartimin e projektkalendarit;
- veprimet pas mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve;
- përpilimin e rendit të ditës të seancave plenare;
- veprimet për të gjitha çështjet e parashikuara në rendin e ditës pas shqyrtimit të tyre;
- duke filluar nga muaji shtator 2016, në zbatim të shkresës së Sekretares së Përgjithshme për të filluar punën reale në platformën *e-parlament*, Shërbimi i Seancës Plenare ka punuar normalisht me sistemin e sipërpërmendur, duke respektuar të gjitha kërkesat dhe afatet që kërkon ky sistem në të gjitha fazat e procesit legjislativ.

❖ **Në kuadër të rritjes së mëtejshme të transparencës** së veprimtarisë parlamentare në seancë plenare, gjatë sesionit të vjeshtës (shtator–dhjetor 2016) Shërbimi i Seancës Plenare u angazhua për përpunimin e mëtejshëm statistikor të të dhënave që publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit. Kështu, nga shtatori ka filluar publikimi në faqe i listës së diskutuesve për çdo seancë plenare dhe për çdo projektligj, së bashku me minutazhin e konsumuar nga deputetët apo anëtarët e Këshillit të Ministrave. Gjithashtu në faqen e Kuvendit nga shtatori 2016 ka filluar publikimi i rubrikës “*Si kanë votuar deputetët*”, e cila paraqitet në mënyrë grafike dhe në përmbledhëse mujore. Këto janë një risi e punës së Shërbimit, të cilat do të pasurohen me të dhëna të tjera në vitin e ardhshëm.

Shërbimi Juridik. Organizimi dhe funksionimi i Shërbimit Juridik ka vijuar të mbështetet në zbatimin e objektivave vjetorë të administratës së Kuvendit dhe në parimet e paanshmërinë dhe profesionalizmit.

❖ **Shërbimi Juridik** i ka dhënë rëndësinë e duhur funksionit të tij në dhënien e ndihmës dhe këshillimit ligjor të deputetëve, me qëllimin kryesor shmangien e mospërputhshmërisë kushtetuese dhe harmonizimin e projektligjeve me kuadrin ligjor të brendshëm.

❖ **Këshilltarët juristë** kanë përgatitur 228 memo për projektligjet, marrëveshjet ndërkombëtare, projektvendimet dhe projektrezolutat e shqyrtuara në komisionet e përhershme dhe nënkomisionet e ngritura pranë tyre.

❖ **Rreth 80 për qind e amendamenteve të propozuara** në opinionet ligjore (memot) e këshilltarëve juristë për projektligjet janë paraqitur edhe në raportet e komisioneve të përhershme.

❖ **Këshilltarët e Shërbimit Juridik** kanë bashkëpunuar me deputetët anëtarë të komisioneve të përhershme për përgatitjen e relacioneve të tyre në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe ngritjes së çështjeve problematike parimore apo të përmbajtjes nën për nën të projektligjit. Shërbimi Juridik ka realizuar përgjegjësitë dhe kompetencat e tij në përputhje me Kushtetutën, Rregulloren e Kuvendit



dhe kuadrin ligjor, me qëllim përfundimin e procedurave parlamentare për miratimin e akteve (ligje, vendime, rezoluta) për seancat plenare dhe zbardhjen e akteve për t'u finalizuar me firmosjen nga Kryetari i Kuvendit.

❖ **Këshilltarët juristë** kanë marrë pjesë në të gjitha grupet e punës të ngritura me urdhër të Sekretares së Përgjithshme, duke dhënë kontributin e tyre në përgatitjen e materialeve të ndryshme në ndihmë të deputetëve, administratës së Kuvendit dhe funksionimit të përditshëm të shërbimeve që e përbëjnë atë, si dhe në grupe pune ndërinstitucionale për hartimin e akteve të ndryshme.

❖ **Këshilltarët juristë** kanë asistuar si staf mbështetës komisionet e posaçme (2) dhe komisionet hetimore (5) të ngritura gjatë legjislaturës, duke këshilluar deputetët për çështje të ndryshme që lidhen me funksionimin e këtyre komisioneve, si dhe duke përgatitur bazën dokumentare të tyre.

❖ **Gjatë vitit 2016 Shërbimi Juridik ka përgatitur materiale** mbrojtëse, shpjegime, propësime dhe përfaqësim (në datat kur janë zhvilluar seancat gjyqësore) të Kuvendit në Gjykatën Kushtetuese për 6 çështje. Me autorizim të Sekretares së Përgjithshme këshilltarët e Shërbimit Juridik gjatë vitit 2016 kanë përgatitur propësime, shpjegime përfundimtare, provat, ankimimet dhe rekursat në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, në Gjykatën e Lartë për 34 çështje.

Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit (SHPL) është një nga 4 shërbimet që përbëjnë Shërbimin Legjislativ në Kuvend, i cili ka për mision t'i ofrojë Kuvendit, komisioneve të përhershme të Kuvendit dhe deputetëve asistencën e nevojshme tekniko-ligjore në procesin e përafrimit të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë me legjislacionin e Bashkimit Europian (*acquis* e BE-së), si dhe të mbështesë punën e Kuvendit në procesin e integritimit europian në tërësi. SHPL-ja është një strukturë me staf të kualifikuar (ekspertë) në fushën e së drejtës dhe të politikave të BE-së, që aktualisht përbëhet nga drejtori dhe tre këshilltarë juristë.

❖ **Gjatë vitit 2016 Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit ka përmbushur misionin e tij** si dhe ka realizuar të gjitha detyrat funksionale të parashikuara në *Manualin e përshkrimit të punëve në administratën e Kuvendit* dhe në *Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të Kuvendit* (shih grafikun dhe tabelën në faqen 3).

❖ **SHPL-ja** ka mbështetur në mënyrë efektive Kuvendin e Shqipërisë me ekspertizë juridike të një standardi të lartë në çështjet e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian përmes hartimit të opinioneve ligjore dhe relacioneve **për 37 projektligje** që i janë propozuar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

❖ Në opinionet ligjore dhe relacionet që ka hartuar për projektligjet që i janë propozuar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim **ka sugjeruar 93 vërejtje, nga të cilat 87 (ose 93.54% e tyre)** janë pranuar nga Komisioni për Integritimin Europian (KIE) dhe komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit gjatë shqyrtimit dhe miratimit të këtyre projektligjeve.


❖ **Është përmirësuar cilësia dhe saktësia e vërejtjeve të paraqitura** në opinionet ligjore dhe relacionet e hartuara nga SHPL-ja, e matur kjo me rritjen e përqindjes së pranueshmërisë së vërejtjeve të SHPL-së nga Komisioni për Integritimin Europian dhe komisionet e tjera të përhershme parlamentare (**nga 92.40% që ishte në vitin 2015, në 93.54% në vitin 2016, ose + 1.14%**). Kjo është përqindja më e lartë e pranueshmërisë së vërejtjeve të SHPL-së nga komisionet parlamentare që nga ngritja e SHPL-së (viti 2007) e në vijim.



❖ Janë paraqitur **14 sugjerime më shumë dhe janë pranuar 14 sugjerime më shumë në vitin 2016** (sugjeruar 93, pranuar 87) **sesa në vitin 2015** (sugjeruar 79, pranuar 73).

❖ Ka bashkërenduar punën me shërbimet e tjera të Kuvendit për përgatitjen në kohë dhe sipas formatit të kërkuar të **7 raporteve/informacioneve**, të cilat i janë kërkuar Kuvendit gjatë vitit 2016 në kuadër të procesit të integritetit evropian.

❖ Në bashkëpunim me Zyrën e Projekteve në Kuvend ka ndjekur **të gjithë hapat e ndërmarrë nga Kuvendi gjatë vitit 2016 në kuadër të zbatimit të projektit të binjakëzimit “Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE”**, në kuadër të Programit të veprimit IPA 2014 për Shqipërinë.





Kapitulli 2



KONTROLLI PARLAMENTAR

Gjatë vitit 2016 veprimtaria e Kuvendit është shtrirë edhe në ushtrimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes parlamentare, si funksion tjetër kushtetues i tij. Kuvendi ka ushtruar kontroll jo vetëm mbi ekzekutivin, por ka mbikëqyrur edhe veprimtarinë e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj. Këtë kontroll Kuvendi e ka ushtruar nëpërmjet mekanizmave ligjorë të parashikuar në Kushtetutë e në Rregulloren e Kuvendit. Kështu, Kuvendi ka ushtruar kontroll mbi ekzekutivin nëpërmjet instrumenteve të tilla ligjore si: interpelancat, kërkesat për informacion, seancat dëgjimore për çështje të zbatueshmërisë së ligjeve, komisioneve hetimore, seancës së pyetjeve etj.

Disa prej instrumenteve parlamentare të zbatuara nga organet e Kuvendit gjatë vitit 2016 janë përdorur me efikasitet nga komisionet e përhershme parlamentare dhe nënkomisionet gjatë këtyre proceseve:

- gjatë fazës së raportimit vjetor të institucioneve të pavarura;
- gjatë fazës së miratimit të buxhetit të këtyre institucioneve;
- në lidhje me propozimet për ndryshime në strukturat e institucioneve të pavarura;
- gjatë informimit periodik dhe njohjes së problematikave nga organet e Kuvendit, si dhe gjatë konsultimeve të gjera në procesin ligjvënës;
- në marrjen e nismave për të krijuar mekanizma të rinj efikas për të përmbushur objektivat e integritetit;
- gjatë procesit zgjedhës dhe emërues.

Kontrolli parlamentar në seancë plenare gjatë kësaj periudhe paraqitet si vijon:





❖ **Interpelancat**

Në kuadër të kompetencave të kontrollit vlen të theksohet kontrolli që është ushtruar mbi ekzekutivin nëpërmjet instrumentit më të rëndësishëm të kontrollit parlamentar - interpelancës¹⁶. Gjatë vitit 2016 janë zhvilluar dy interpelanca si më poshtë:

- Me ministrin e Infrastrukturës dhe Transportit lidhur me ecurinë e punës në Rrugën e Arbrit, kërkuar nga Grupi Parlamentar i PDIU-së.
- Me Kryeministrin lidhur me hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian (interpelancë urgjente).

❖ **Pyetjet me shkrim**

Gjatë vitit 2016 është zhvilluar vetëm një seancë pyetjesh, kërkuar nga deputetja Kejdi Mehmetaj, me ministren e Arsimit dhe Shkencës lidhur me pranimet në universitetet publike. Deputetja kërkoi që përgjigjja e ministres t'i jepej me shkrim.

❖ **Kërkesa për informacion¹⁷**

Ky instrument kontrolli vazhdon të paraqitet shumë dominues në krahasim me mjetet e tjera të kontrollit.

Viti 2016 numëron 72 të tilla drejtuar titullarëve të institucioneve shtetërore dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave. Janë kërkuar kryesisht nga deputetë të opozitës. Janë marrë përgjigje për 48 prej tyre brenda afatit trejavor.

❖ **Rezolutat**

Gjatë vitit 2016 Kuvendi ka miratuar 20 rezoluta. Dy rezoluta kanë pasur për objekt nderimin dhe mirënjohjen e thellë të Republikës së Shqipërisë për figurën e Presidentit të Kosovës Ibrahim Rugova dhe dënimin e krimeve të komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e veçantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtave e lirive themelore të njeriut.

Gjatë vitit 2016 Kuvendi ka miratuar 18 rezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së institucioneve të pavarura gjatë vitit 2015, për të cilat ka lënë detyra me afate konkrete për institucionet përkatëse, duke bërë kështu të mundur një monitorim më efektiv të veprimtarisë së këtyre institucioneve dhe një rritje të rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Shqipërisë, gjë e cila është vlerësuar edhe në raportin e fundit të progresit të Komisionit Europian për Shqipërinë, në të cilin thuhej: “Kuvendi ka realizuar një proces më të strukturuar të shqyrtimit të raporteve vjetore të institucioneve të pavarura dhe miratoi 16 rezoluta.”

Në zbatim të nenit 103 të Rregullores së Kuvendit si dhe të neneve respektive në ligjet organike të institucioneve të pavarura që raportojnë në Kuvend, bazuar në kalendarin e raportimit të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve në janar 2016, janë paraqitur 18 raporte vjetore të institucioneve të pavarura si dhe dy raporte të institucioneve të varësisë së ekzekutivit në kuadër të kontrollit parlamentar dhe atij ligjor, por të lidhura me fushën e veprimtarisë dhe zbatimit të ligjit nga institucione të pavarura. Raportet vjetore u janë përcjellë komisioneve parlamentare përgjegjëse për shqyrtimin e veprimtarisë

¹⁶. Në vitin 2015 janë zhvilluar 4 interpelanca.

¹⁷. Në vitin 2015 janë bërë 73 kërkesa për informacion.



vjetore të punës gjatë vitit 2015: për Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Autoritetin e Konkurrencës, Autoritetin e Medieve Audiovizive, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Avokatin e Popullit, Bankën e Shqipërisë, Departamentin e Administratës Publike për gjendjen në Shërbimin Civil, Entin Rregullator të Energjisë, Entin Rregullator të Ujit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Ministrinë e Drejtësisë për inspektimin e organit të Prokurorisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Radiotelevizionin Shqiptar.

Aktiviteti i komisioneve në zbatimin e nenit 103 të Rregullores së Kuvendit për raportimin vjetor të institucioneve të pavarura dhe vlerësimin e punës së tyre për vitin paraardhës është zhvilluar përmes **40 mbledhjeve të komisioneve, të ndara në 22 mbledhje të zhvilluara gjatë fazës së prezantimit të raportit vjetor dhe seancës së pyetjeve-përgjigjeve e diskutimeve dhe 18 mbledhje për miratimin e projektrezolutave nga komisionet përgjegjëse, të cilat janë përcjellë për miratim në seancë plenare.**

Instrumenti i raportimit vjetor është mekanizmi më i rëndësishëm parlamentar që përdor Kuvendi për t'u njohur me punën e institucioneve të pavarura, por dhe me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të tyre nga administrata publike, problematikat që hasin si dhe impakti i zbatimit të masave.

Një aspekt tjetër i aktivitetit të Kuvendit gjatë ushtrimit të kontrollit parlamentar është se komisionet parlamentare kanë shtuar dëgjesat me krerë institucionesh në fokus të problematikave të konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ku mund të përmendim seancat dëgjimore me fokus kontrollin parlamentar të ushtruar nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat për shqyrtimin e raportit të KLSH-së për BSH-në, AMF-në si dhe raportin e KLSH-së për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2015. Po ashtu komisionet kanë vijuar praktikën e mirë të marrjes së opinioneve apo informacioneve të institucioneve të tjera ligjzbatuese dhe organizmave të tjerë që mbikëqyrin apo bashkërendojnë punën e veprimet të këtyre institucioneve të pavarura që raportojnë punën e tyre para Kuvendit. Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar aktivitete me fokus zbatimin e ligjit në fushat e të drejtave të njeriut.

1. Gjatë fazës së miratimit të buxhetit të këtyre institucioneve:

- Janë zhvilluar 9 seanca dëgjimore me përfaqësues të institucioneve të pavarura buxhetore gjatë fazës së shqyrtimit dhe miratimit të projektbuxhetit të shtetit për vitin 2017 me institucionet e pavarura, si: KQZ, PP, ILDKPKI, KMD, KMSHC, KDIMDP, Avokati i Popullit, RTSH, ISKK, për të cilat ka pasur prioritete për t'u plotësuar si kërkesa nga komisionet.

- Disa institucione, si AMF, BSH, ASD, AMA, AKEP, ERE, ERRU, nuk përfshihen në procesin e dëgjesave, për arsye se janë institucione me vetëfinancim dhe në bazë të ligjit nuk përfitojnë nga buxheti i shtetit.

2. Në lidhje me propozimet për ndryshime në strukturat e institucioneve të pavarura:

- Seanca dëgjimore në varësi të kërkesave të institucioneve për ndryshime në strukturë apo miratim strukturash. Është miratuar struktura e re e AMA-së, janë miratuar ndryshimet shitesë në strukturën e ILDKPKI-së dhe atë të ERRU-së. Është bërë ndryshim ligji për pagat lidhur me parashikimin e emërtesës së Autoritetit të Dosjeve dhe pagën referuese të tij sipas këtij ligji, si dhe miratimi i strukturës së këtij institucioni të ri të krijuar në fund të vitit 2016.

3. Gjatë vitit 2016 ka pasur një shkëmbim të shpeshtë dhe të rregullt të informacionit ndërmjet



institucioneve të pavarura dhe Kuvendit e strukturave të tij për çështje thelbësore të veprimtarisë së tyre përmes korrespondencës shkresore me informacione specifike, kërkesave për interpretime apo dhe raporteve e buletineve të veçanta të tyre. **Janë informuar organet e Kuvendit për 44 çështje të tilla.**

4. Mekanizmi i ri institucional. Në kuadër të raportit të progresit për vitin 2016, në të cilin thuhej **Megjithatë, ende duhet të zhvillohet një ndjekje (follow-up) e plotë dhe një sistem monitorimi të rekomandimeve nga Kuvendi dhe institucionet e pavarura, por dhe në përmbushje të objektivave të vetë Kuvendit në këtë drejtim,** me nismën e Kryetarit të Kuvendit më 1 nëntor 2016 u organizuar tryeza e rrumbullakët me temë: “Kuvendi dhe institucionet e pavarura: identifikimi i mekanizmave institucionalë për **ndjekjen dhe zbatimin efikas të rekomandimeve të institucioneve të pavarura me fokus kryesor ato në fushën e të drejtave dhe të auditimit publik.**” Projektmekanizmi i hartuar paraprakisht nga Shërbimi i Monitorimit u diskutua dhe gjeti përkrahjen e të gjitha institucioneve të pavarura që raportojnë dhe kanë marrëdhënie ndërveprimi me Kuvendin dhe është një nga prioritetet kryesore të punës së Shërbimit të Monitorimit në varësi të funksioneve dhe të vendimmarrjes parlamentare të organeve të Kuvendit, të organeve dhe institucioneve shtetërore si dhe të vetë institucioneve të pavarura gjatë vitit 2017 e në vijim.

❖ **Forcimi i rolit të Kuvendit në procesin e integritetit evropian**

Krijimi dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar të Integritetit Evropian¹⁸ (KKIE) ka forcuar më tej rolin kontrollues të Kuvendit në procesin e integritetit evropian, duke mundësuar forcimin e vazhdueshëm të rolit të tij, si një aktor i rëndësishëm në monitorimin e detyrimeve të anëtarësimit.

Monitorimi i zbatimit të detyrimeve të procesit të integritetit, veçanërisht i 5 prioritetëve kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e tyre, ka qenë fokusi kryesor i veprimtarisë së këtij Këshilli për vitin 2016.

Gjatë këtij viti janë zhvilluar 6 takime periodike të Këshillit, me pjesëmarrjen e anëtarëve, të ftuarve të përhershëm, ministrave, përfaqësuesve të institucioneve të pavarura, përfaqësuesve të shoqërisë civile si dhe përfaqësuesve nga Komisioni Evropian, me qëllim diskutimin me bazë sa më të gjerë të ecurisë së procesit të integritetit evropian të Shqipërisë dhe sfidave që paraqet faza aktuale e procesit.

Në zbatim të rolit të tij, si një garantues i dialogut gjithëpërfshirës, KKIE-ja ka pasur në fokus promovimin e përfshirjes së të gjithë aktorëve të procesit të integritetit evropian. Në këtë kuadër, shoqëria civile ka luajtur një rol shumë aktiv në takimet e KKIE-së, duke sugjeruar përmirësime konkrete në dokumente të rëndësishme, të marra në shqyrtim gjatë mbledhjeve të Këshillit për vitin 2016.

Gjithashtu Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian gjatë vitit të parë të funksionimit të tij ka evidentuar nevojën për përfshirjen e të gjithë aktorëve në realizimin e reformave dhe detyrimeve të anëtarësimit, në sinergji të plotë me institucionet që koordinojnë e menaxhojnë procesin e integritetit.

Në këtë kuadër, në përputhje edhe me vullnetin e demonstruar të Kuvendit të Shqipërisë për të qenë një forum i hapur për botën akademike, për shoqërinë civile dhe për të gjithë personat që ofrojnë ekspertizë në fusha të ndryshme, me vendimin nr. 69, datë 4.05.2016 të Byrosë së Kuvendit u ngrit Shkolla Verore Europiane, e cila ka si qëllim ta zhvillojë më tej rolin e tyre, duke siguruar vazhdimësinë e angazhimit në këtë proces. Shkolla Verore Europiane u zhvillua në datat 26–30 shtator 2016 me pjesëmarrjen e 37 përfaqësuesve nga administrata publike, përfaqësues të organizatave joqeveritare

¹⁸. Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian është krijuar në bazë të ligjit nr. 15/2015, datë 5.03.2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, si një instrument i rëndësishëm për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse lidhur me reformat integruese të vendit.



si dhe gazetarë, të cilët synojnë të jenë të përfshirë gjatë procesit të negociatave të anëtarësimit. Leksionet u mbajtën nga profesorë të Kolegjit të Europës (Bruges), ekspertë të nivelit të lartë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për integrimin europian dhe procesin e zgjerimit, si dhe përfaqësues të ftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, qeveria dhe Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve institucionale, me vendimin e Byrosë së Kuvendit nr. 61, datë 3.02.2016 u krijua Drejtoria e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Integritit Europian, e cila ka për mision të ofrojë asistencë teknike dhe administrative për Këshillin në mbështetje të përmbushjes së misionit të tij si struktura më e lartë kombëtare për integrimin europian, që nxit dhe garanton bashkëpunimin gjithëpërfshirës, mbikëqyr ecurinë e zbatimit të detyrimeve të procesit të integritit, si dhe siguron rritjen e transparencës në vendimmarrjen për këtë proces.

Krijimi i këtij shërbimi të ri është vlerësuar edhe nga Komisioni Europian në raportin e tij për Shqipërinë për vitin 2016, ku thuhet se *kapacitetet e Këshillit Kombëtar për Integrimin Europian u rritën me shtimin e një njësie mbështetëse të dedikuar.*



Kapitulli 3

FUNKSIONI ZGJEDHËS

Procesi zgjedhës i Kuvendit për plotësimin e vakancave në organet kolegjiale dhe/ose titullarëve në ato monokratike

Gjatë vitit 2016 Kuvendi ka ushtruar funksionin zgjedhës, ku Komisioni i Ligjeve, ai i Ekonomisë dhe i Medie kanë zhvilluar seanca dëgjimore me kandidatura gjatë procesit të plotësimit të vakancave në institucionet e pavarura apo dhe krijim institucioneve të reja:

❖ Seanca dëgjimore me kandidaturat e propozuara për kryetar të KQZ-së dhe për anëtar të KQZ-së, seanca dëgjimore me kandidaturat për 4 vendet vakante për anëtarë të AMA-s, seanca dëgjimore me kandidaturën për një anëtar të Këshillit Mbikëqyrës së BSH-së, seanca dëgjimore me 4 kandidaturat për dy vendet vakante për anëtar të Autoritetit të Konkurrencës, seanca dëgjimore dhe shqyrtimi për kandidaturat për anëtarë të Autoritetit të Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit, seanca dëgjimore me kandidaturat e vetofrura për komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjithsej janë zhvilluar 10 mbledhje komisionesh për dëgjesat e 49 kandidatëve për zgjedhjen e 18 titullarëve apo anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura dhe janë marrë 17 vendime zgjedhesh në pozicionet e mandatuara nga Kuvendi për institucionet e pavarura si dhe një vendim për procedurën paraprake të përzgjedhjes së një drejtuesi institucioni, ku konkretisht janë zgjedhur duke plotësuar vakancat në institucione si më poshtë:

- një anëtar i Këshillit Drejtues të BSH-së;
- një anëtar i bordit të AMF-së;
- katër anëtarë të AMA-s;
- dy anëtarë të Autoritetit të Konkurrencës dhe kryetari i Autoritetit të Konkurrencës;
- 5 anëtarë dhe kryetari i Autoritetit për Informimin e Dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit;
- një anëtar i KQZ-së dhe kryetari i KQZ-së.

Mbështetja e punës së organeve të Kuvendit nga Shërbimi i Monitorimit

❖ Gjatë vitit 2016 Shërbimi i Monitorimit ka mbështetur organet e Kuvendit gjatë procesit të ushtrimit të kontrollit parlamentar dhe atij zgjedhës duke asistuar me materiale Kryetarin e Kuvendit, komisionet parlamentare, grupet parlamentare dhe Sekretaren e Përgjithshme përmes analizave gjatë fazës së raportimit vjetor, përfshirë relacionet, raportet dhe projektrezolutat e komisioneve gjatë këtyre proceseve, hartimi i projektvendimeve për struktura dhe zgjedhje organesh, përpunimi i të dhënave apo informacioneve të tjera të sjella në Kuvend, si raporte periodike, zbatimi i rekomandimeve të institucioneve të pavarura mbikëqyrëse dhe zbatuese të ligjit, raporte të veçanta, raporte auditimi,



informacione të tjera të fushës, opinione dhe interpretime ligjore të adresuara nga vetë institucionet për Kryetarin e Kuvendit dhe komisionet parlamentare.

❖ **Gjithashtu këshilltarët e Shërbimit të Monitorimit** kanë mbështetur komisionet edhe me analiza ligjore për ligje, si p.sh. me përgatitje prapësimesh për shqyrtimin e dekretit për kthimin e ligjit 22/2016 për disa ndryshime në ligjin e medias, si dhe kanë përgatitur amendamente për Statutin e RTSH-së, memo ligjore për hapat proceduralë të organeve të Kuvendit pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e një neni të ligjit të medias; kanë paraqitur analizë dhe amendamente për projektligjin për bilbilfryrësit si dhe për projektligjin për zhvillimin e mjeteve të komunikimit elektronik të shpejtësisë së lartë dhe sigurimit të së drejtës së kalimit, ligjin për Shërbimin Civil dhe ligjin e pagave për amendimet e propozuara nga deputetët lidhur me normimin e këtyre marrëdhënieve me institucionet e pavarura; janë caktuar si këshilltarë në komisione hetimore të ngritura me vendim të Kuvendit, ku kanë përgatitur vendime e memo ligjore për funksionimin e komisionit.

❖ **Ndërkohë këshilltarë të Shërbimit kanë bërë analiza krahasuese të ligjit për mediet auditive dhe në bashkëkoordinim me këshilltarë të Shërbimit Juridik** kanë paraqitur prapësime në Gjykatën Kushtetuese për ligjin e medias, si dhe kanë bashkëpunuar me Shërbimin Juridik edhe për dy rekurse në Gjykatën e Lartë.

❖ **Po ashtu këshilltarët kanë përgatitur memo për auditimin e KLSH-së dhe analizë për auditimin e institucioneve të pavarura**, kanë dhënë mendime në një projektvendim të qeverisë për sigurimin suplementar të funksioneve në institucione të pavarura, si dhe kanë mbështetur me materiale informuese e krahasuese si dhe fjalë për Kryetarin e Kuvendit dhe deputetë në takimet e tyre jashtë dhe brenda vendit në aktivitetet parlamentare.

❖ **Shërbimi i Monitorimit** gjatë vitit është përfaqësuar në grupet e posaçme ndër-institucionale të punës të ngritura për zbatimin e prioritetëve të *road map* të BE-së, ku është raportuar periodikisht gjatë gjithë vitit me materiale të përditësuara për kapitullin 10: “Shoqëria e informacionit dhe media”; kapitulli 7: “Për raportin e KLSH-së dhe *follow-up* i tij”; Prioriteti 1, *Reforma në administratën publike, Strategjia antikorruption dhe hartimi i Planit të veprimit* dhe përditësimi i tij pranë Ministrisë për Çështjet Vendore dhe Koordinatorin për Antikorruptionin, *Kontributet për KSA-në, Kontributi i parë 6-mujor dhe Kontributi i dytë 6-mujor*.

❖ **Shërbimi i Monitorimit ka përgatitur menjëherë pas daljes së raportit të progresit për vitin 2016 analizën e tij krahasuese për secilin institucion me konstatimet**, si dhe ka hartuar një plan veprimi në raport me detyrat e Kuvendit, të cilat i ka bërë pjesë përfshirëse edhe të objektivit në *Planin e veprimit* të Kuvendit për vitin 2017 për forcimin e rolit mbikëqyrës së Kuvendit dhe monitorimin e institucioneve të pavarura.

❖ **Shërbimi ka bërë vlerësime edhe për raportin e Sigmës dhe raportin e *Transparency International* për punën e Kuvendit**, si dhe ka hartuar **Plan veprimin për *follow-up* të rekomandimeve të konferencës së 3 shkurt 2015** të kryer nga Misioni i Vlerësimit të ekspertëve të Komisionit European për funksionimin ligjor dhe pavarësinë e institucioneve të pavarura. Po ashtu Shërbimi ka përgatitur materiale informuese për konstatimet e misionit të vlerësimit për lirinë e shprehjes në Shqipëri dhe ua ka bërë të ditura ato organeve të Kuvendit.

❖ **Me urdhër të Kryetarit të Kuvendit nr. 23 dt. 17.03.2016 Shërbimi i Monitorimit është struktura e posaçme e ngritur në Kuvend për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e**



formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 për subjektet që kanë detyrim të dorëzojnë te Kryetari i Kuvendit.

Me qëllim zbatimin e këtij ligji, që prej përfundimit të afatit ligjor të plotësimit të formularëve nga subjektet e ligjit më 4 maj 2016 e në vijim gjatë vitit 2016 Shërbimi i Monitorimit ka administruar, skanuar dhe publikuar në përputhje me ligjin rreth 150 formularë vetëdeklarimi. Për çdo kandidaturë të paraqitur në Kuvend për zgjedhje në institucionet e pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj është administruar dhe publikuar menjëherë formulari i vetëdeklarimit në faqen zyrtare të Kuvendit. Është mbajtur korrespondenca përkatëse me institucionet e ngarkuara me ligj për këtë proces, si dhe është krijuar një databazë me të gjitha të dhënat.

❖ Në total këshilltarët e Shërbimit të Monitorimit kanë ofruar 274 materiale për proceset e mësipërme, nga të cilat 211 për proceset e kontrollit parlamentar dhe të lidhura me çështje të institucioneve të pavarura dhe 63 për zbatim urdhrash administrativë e kontribute mbështetëse jo të lidhura me objektin parësor të punës së SHMI-së.



Kapitulli 4

VEPRIMTARIA E ORGANEVE TË KUVENDIT

Gjatë vitit 2016 organet drejtuese kanë zhvilluar mbledhje për trajtimin e çështjeve të ndryshme që, sipas Rregullores, janë në kompetencën e tyre:

- **Konferenca e Kryetarëve** ka zhvilluar 28 mbledhje për miratimin e programit të punës, të kalendarit trejavor, kalendarit të raportimeve të disa institucioneve kushtetuese dhe atyre të ngritura me ligj; kalendarit të shqyrtimit të projektbuxhetit dhe paketës fiskale; kërkesa për ndryshim të rendit të ditës, për ngritje të komisioneve hetimore apo të posaçme, propozime për ndryshime në komisione të përhershme, kërkesa nga grupet parlamentare etj. Konferenca ka miratuar me mirëkuptim apo ka dërguar për miratim në seancë plenare në rastet kur nuk është arritur mirëkuptimi 8 programe gjashtëjavore, 14 kalendarë trejavorë dhe 2 kalendarë njëjavor.

- **Byroja e Kuvendit** ka zhvilluar 12 mbledhje për çështje administrative dhe funksionimin e brendshëm të Kuvendit, masa disiplinore ndaj deputetëve që kanë cenuar rëndë mbarëvajtjen e punimeve të parlamentit në seancë plenare etj.

- **Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin** ka zhvilluar 4 mbledhje për verifikim mandati, çështje që lidhen me mandatin e deputeteve, interpretimin e dispozitave të Rregullores dhe hartimin e vendimit për zbatimin e ligjit të dekriminalizimit.

❖ **Krijimi i strukturave të reja parlamentare**

Gjatë vitit 2016 Kuvendi ka ngritur 4 komisione hetimore (3 me kërkesë të opozitës dhe 1 me kërkesë të mazhorancës parlamentare), si dhe ka shtyrë zgjatjen e afatit për komisionet e posaçme të ngritura në vitet e mëparshme.

❖ **Lëvizjet në grupe parlamentare**

Gjatë vitit 2016, në përputhje me kërkesat e Rregullores, ka pasur disa ndryshime në përbërje të grupeve parlamentare, si më poshtë:

- Deputetja Mesila Doda bëhet anëtare e grupit parlamentar të partisë “Drejtësi, Integritet dhe Unitet”.

- Deputetët Ben Blushi dhe Mimoza Hafizi largohen nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste.

- Deputetët Mimoza Hajdarmataj dhe Alban Zeneli bëhen anëtarë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.



❖ *Deputetë të rinj*

Gjatë periudhës viti 2016 dy deputetë kanë fituar mandatin si vijon:

- Edmond Leka - anëtar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
- Dhurata Çupi - anëtare e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

❖ **Kërkesa për të konstatuar papajtueshmëri me mandatin e deputetit**

Kuvendi gjatë vitit 2016 ka shqyrtuar 2 kërkesa të paraqitura nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike lidhur me çështjen e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit për z. Rakip Suli dhe znj. Valentina Leskaj. Kuvendi është shprehur me vendim për dërgimin e këtyre çështjeve në Gjykatë Kushtetuese.



Kapitulli 5

VEPRIMTARIA NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2016 në fokus të veprimtarisë së marrëdhënieve me jashtë të Kuvendit të Shqipërisë ka qenë forcimi dhe aktivizimi i marrëdhënieve ndërparlamentare me vendet anëtare të BE-së, me vendet e rajonit dhe vende me të cilat Shqipëria ka interesa strategjikë. Viti 2016 ishte mjaft i rëndësishëm për sa u përket veprimtarive ndërkombëtare parlamentare dhe diplomacisë parlamentare shqiptare. Në këtë kuadër një sërë veprimtarish të marrëdhënieve me jashtë kishin si objektiv:

- intensifikimin e punës në nivel parlamentar për avancimin me axhendën europiane të Shqipërisë;
- rritjen dhe forcimin e kontakteve mes parlamenteve të vendeve të ndryshme, me synim nxitjen e mëtejshme të diplomacisë parlamentare;
- intensifikimin e bashkëpunimit rajonal, me synim nxitjen e projekteve të përbashkëta dhe intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik mes këtyre vendeve.

Për arritjen e objektivave të veprimtarisë së marrëdhënieve me jashtë Kuvendi i Shqipërisë ka realizuar një axhendë mjaft të ngjeshur me aktivitete të shumta në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe, e cila e përmbledhur është si më poshtë:

- **8** vizita të kryeparlamentarëve të vendeve të huaja zhvilluar në Shqipëri;
- **12** vizita të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë me ftesë të homologëve të tij jashtë vendit;
- **67** takime të Kryetarit të Kuvendit me personalitete nga vende të ndryshme, si presidentë, kryeministra, ministra të jashtëm, ambasadorë etj.;
- **10** takime të nënkryetarëve të Kuvendit me personalitete të ndryshme;
- **47** takime të kryetarëve të komisioneve të Kuvendit të Shqipërisë me personalitete të ndryshme ndërkombëtare;
- **3** pjesëmarrje të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në konferenca dhe aktivitete të ndryshme;
- **49** pjesëmarrje të delegacioneve të përhershme të Kuvendit të Shqipërisë pranë organizatave ndërkombëtare;
- **6** aktivitete shumëpalëshe të organizuara në Kuvendin e Shqipërisë;
- **5** pjesëmarrje në aktivitete dhe seminare të deputetëve dhe stafit të administratës së Kuvendit të Shqipërisë zhvilluar nga Parlamenti Europian.

Ky vit ka qenë i rëndësishëm për Kuvendin e Shqipërisë edhe në kuadër të aktiviteteve ndërkombëtare shumëpalëshe. Kuvendi ka organizuar më 18–19 shkurt sesionin e 10-të plenar të Asamblesë Parlamentare të vendeve të Mesdheut (PAM). Ky sesion i zhvilluar në Tiranë shënoi pjesëmarrjen më të gjerë në historinë e kësaj organizate si dhe pjesëmarrjen e 5 kryetarëve të parlamenteve të vendeve pjesëmarrëse. Asamblenë e përshëndeti përmes komunikimit *on line* edhe Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Ban Ki-Mun (*Ban Ki-moon*).

Në kuadër të aktiviteteve shumëpalëshe të zhvilluara në Shqipëri duhet veçuar organizimi i Sesioni të Pranverës të Asamblesë Parlamentare të NATO-s. Ky sesion, i mbajtur për herë të parë në Tiranë më 27–30 maj, ishte aktiviteti me pjesëmarrjen më të madhe të organizuar ndonjëherë nga Kuvendi i Shqipërisë.



Në këtë konferencë morën pjesë rreth 260 parlamentarë nga 28 vende anëtare të Aleancës nga Amerika e Veriut dhe Europa si dhe delegatë nga vendet partnere e vëzhgues, të cilët diskutuan çështje të sigurisë ndërkombëtare. Në punimet e këtij sesi u zhvilluan 5 mbledhje komisionesh të Asamblesë Parlamentare të NATO-s: Komisioni i Politikës, Mbrojtjes dhe Sigurisë, Shkencës dhe Teknologjisë, Dimensionit Civil të Sigurisë, Ekonomisë dhe Sigurisë. Në secilin komision mbajtën fjalën përfaqësues të qeverisë, akademikë, përfaqësues të OJQ-ve dhe NATO-s. Konferenca u drejtua nga Presidenti i Asamblesë Parlamentare të NATO-s Michael Turner.

Të tjera aktivitete shumëpalëshe të organizuara në Tiranë përmendim: takimi i Komisionit të Përgjithshëm për Zhvillimin Social, Edukimin, Kërkimin dhe Shkencën të Asamblesë Parlamentare të SEECP-së, konferencën vjetore të grave parlamentare të rajonit, takimin e 10-të të Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit BE-Shqipëri (KPSA) si dhe takimin e Komisionit për Respektimin e Detyrimeve dhe Angazhimeve nga Vendet Anëtare të Këshillit të Europës (Komisioni i Monitorimit).

A. Aktivitete në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe

Në funksion të zgjerimit të kontakteve dhe intensifikimit të bashkëpunimit me parlamentet e vendeve të tjera si dhe nxitjen e diplomacisë parlamentare shkëmbimet në nivel dypalësh kanë qenë mjaft aktive dhe të kënaqshme. Në këtë kuadër **Kryetari i Kuvendit ka realizuar 10 vizita zyrtare jashtë vendit** dhe konkretisht në SHBA, Gjermani, Greqi, Kinë, Vatikan, Belgjikë, Suedi.

21 shkurt: vizitë Zyrtare e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Suedi.

Zoti Meta u prit nga homologu i tij, Kryetari i Riksdagut, z. Urban Ahlin. Dy delegacionet parlamentare zhvilluan bisedime mbi marrëdhëniet dypalëshe, intensifikimin e bashkëpunimit ndërparlamentar dhe zhvillimet e fundit në rajonin e Ballkanit dhe në BE. Kryetari i Kuvendit i shprehu homologut të tij mirënjohjen e thellë për mbështetjen e pakursyer të Suedisë ndaj zhvillimit ekonomik, social dhe integritetit evropian të Shqipërisë, duke nënvizuar se marrëdhëniet e shkëlqyera politike duhet të reflektojnë një nivel më të lartë shkëmbimesh ekonomike e tregtare dhe se dy parlamentet mund të luajnë një rol kyç dhe parësor në intensifikimin e kontakteve.

8 prill: vizitë zyrtare e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Kosovë.

9 maj: vizitë zyrtare e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në SHBA, ku zhvilloi disa takime me përfaqësues të qeverisë amerikane, në Kongresin dhe Senatin amerikan, si dhe zhvilloi një numër tryezash dhe aktiviteteve publike.

Gjithashtu zoti Meta pati një takim në Departamentin e Shtetit me zëvendësndihmëssekretarin Hoyt Yee dhe një takim me zëvendësndihmësprokurorin e përgjithshëm dhe këshilltar për marrëdhëniet ndërkombëtare në Departamentin e Drejtësisë, z. Bruce Swartz, ku pjesëmarrës ishin edhe drejtuesit e programit OPDAT dhe ICITAP për Shqipërinë, si dhe një numër përfaqësuesish të Departamentit të Drejtësisë dhe të Departamentit të Shtetit. Kryetari i Kuvendit gjatë takimit falënderoi Shtetet e Bashkuara për bashkëpunimin 25-vjeçar me shtetin shqiptar e veçanërisht për mbështetjen e pakursyer amerikane për reformat në vendin tonë.

4 qershor: vizitë e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Uashington DC.

Zoti Meta zhvilloi disa takime në Kongresin amerikan, gjatë të cilave rikonfirmoi marrëdhëniet e shkëlqyera dhe partneritetin strategjik mes dy vendeve. Ai mori mbështetjen e përfaqësuesve të Kongresit amerikan për angazhimin në vazhdimësi të SHBA-ve për të ofruar asistencën e nevojshme në fazën e implementimit të reformës, për ngritjen e institucioneve të reja, për procesin e *vetting*-ut të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për rritjen e besimit të integriteti të sistemit të ri të drejtësisë dhe funksionarëve të tij si dhe për funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe të Zyrës së Prokurorit



të Posaçëm për Antikorrupsionin.

11 korrik: vizitë zyrtare e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Mal të Zi me ftesë të homologut malazez Darko Pajović. Zoti Ilir Meta shoqërohej nga kryetarja e Komisionit për Politikën e Jashtme Arta Dade dhe nga kryetari i grupit parlamentar të miqësisë Shqipëri–Mal i Zi zoti Paulin Sterkaj. Dy kryeparlamentarët Meta dhe Pajović vlerësuan marrëdhëniet e shkëlqyera politike e ndërparlamentare mes dy vendeve dhe shprehën bindjen se në kuadër të proceseve integruese euroatlantike dy parlamentet duhet të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre edhe më tej.

Pas takimit Kryetari i Kuvendit, zoti Ilir Meta, mbajti një fjalë përshëndetëse në parlamentin e Malit të Zi, ku i pranishëm ishte edhe Sekretari i Përgjithshëm i OSBE-së Lamberto Zannier (*Lamberto Zannier*).

19 korrik: vizitë e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Uashington.

3 gusht: vizitë zyrtare e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Sllovaki.

Gjatë kësaj vizite zoti Meta u takua në Bratislavë me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Jashtëm të Sllovakisë Miroslav Lajčák (*Miroslav Lajčák*). Presidencën e Këshillit të BE-së për 6-mujorin e dytë të vitit 2016 e mbajti Sllovakia dhe në këtë kuadër Kryetari i Kuvendit vlerësoi presidencën sllovaqe për vëmendjen që i kushtoi zgjerimit dhe integritetit në BE të vendeve të Ballkanit dhe garantoj se Shqipëria do të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për përmbushjen e pesë prioriteteve.

Zoti Lajčák shprehu besimin se politika e zgjerimit nuk do të ndikohet nga zhvillimet e fundit në Europë dhe inkurajoi Shqipërinë të thellojë reformat, duke filluar me zbatimin e suksesshëm të reformës në drejtësi.

3 shtator: Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë në ceremoninë e shenjtërimit të Nënë Terezës. Zoti Meta ishte pjesë e delegacionit shtetëror të vendit tonë, që kryesohej nga Presidenti i Republikës, zoti Bujar Nishani. Kryetari i Kuvendit shoqërohej nga zyrtarë të tjerë të parlamentit shqiptar.

11 shtator: vizitë zyrtare e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Londër.

Zoti Meta u prit nga Kryetari i Dhomës së Deputetëve të parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, z. John Bercow, ministri britanik i Shtetit për Çështjet e Brendshme dhe të Sigurisë, z. Ben Wallace, kryetari i Komisionit parlamentar britanik të Drejtësisë, z. Bob Neill dhe shefja i Departamentit për Ballkanin Perëndimor dhe Zgjerimin në Ministrinë e Jashtme Britanike, ish-ambasadorja e Britanisë në Shqipëri, znj. Fiona McIlwham.

Kryetari i Kuvendit zhvilloi gjithashtu një takim me liderin e Dhomës së Deputetëve të Mbretërisë së Bashkuar, ministër i Kabinetit për Parlamentin, z. David Lidington, dhe me shumë personalitete të tjera.

10–12 tetor: vizitë zyrtare e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Greqi. Delegacioni zhvilloi takime me Kryeministrin e Greqisë z. Aleksis Cipras (*Alexis Tsipras*), me Presidentin e Greqisë, z. Prokopis Pavlopoulos, dhe kryeparlamentarin e Greqisë, z. Nikolaos Voutsis, të cilit i shprehu mirënjohjen për ftesën dhe për mikpritjen e ngrohtë.

17–20 tetor 2016: vizitë zyrtare e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Kinë. Delegacioni zhvilloi takime me Kryetarin e Asamblesë Kombëtare Popullore të Kinës, z. Zhang Dej Iang (*Zhang Dejiang*), me nënkryetaren e Shoqatës së Kinës për Marrëdhënie Miqësore Ndërkombëtare, znj. Deng Rong, me ministrin e Burimeve Ujore të Kinës, z. Chen Lei, me ministrin për Marrëdhëniet me Jashtë të Komitetit




Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, z. Song Tao.

6–8 nëntor: vizitë zyrtare e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Kiel të Gjermanisë, në kryeqendrën e landit të Schleswig-Holstein të Republikës Federale Gjermane, ku u prit në një takim të veçantë nga kryeministri i këtij landi, z. Torsten Albig.

5–7 dhjetor 2016: vizitë zyrtare e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Bruksel.

Aktivitetet në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe



Me ftesë të Kryetarit të Kuvendit, z. Ilir Meta, në kuadër të intensifikimit të marrëdhënieve dypalëshe me vende të tjera për vitin 2016 **janë realizuar në Shqipëri 8 vizita të kryetarëve dhe nënkryetarëve parlamenteve të vendeve të huaja si më poshtë:**

11–12 shkurt: vizitë zyrtare e Kryetarit të Asamblesë Kombëtare të Republikës së Sllovenisë, z. Milan Brglez, i shoqëruar nga një delegacioni i përbërë nga anëtarë të parlamentit slloven. Dy kryeparlamentarët dhe delegacionet e tyre diskutuan mbi thellimin e bashkëpunimit ndërparlamentar mes dy vendeve për çështje rajonale dhe ndërkombëtare. Zoti Meta dhe zoti Brglez nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit midis Kuvendit të Shqipërisë dhe Asamblesë Kombëtare të Sllovenisë, përmes të cilit u institucionalizua bashkëpunimi mes dy parlamenteve dhe u konfirmua vullneti i përbashkët për thellimin dhe rritjen e cilësisë së marrëdhënieve dypalëshe.

17–19 shkurt: vizitë zyrtare e Kryetarit të Parlamentit të Izraelit, z. [Juli-Joel Edelshtajn](#) (*Yuli-Yoel Edelstein*). Gjatë takimit dy homologët biseduan për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe intensifikimin e bashkëpunimit ndërparlamentar dhe ekonomik mes dy vendeve.

22 prill: vizitë zyrtare e Presidentit të Bundestagut Gjerman, prof. dr. Norbert Lamert (*Norbert Lammert*). Dy kryeparlamentarët vlerësuan marrëdhëniet dypalëshe mes Shqipërisë dhe Gjermanisë dhe theksuan se bashkëpunimi i shkëlqyer dhe lidhjet e ngushta ndërparlamentare duhet të orientohen



drejt intensifikimit të shkëmbimeve ekonomike e tregtare. Presidenti i Bundestagut, prof. dr. Norbert Lamert, shprehu vlerësimin për progresin e bërë nga Shqipëria në vite dhe nënvizoi se përsheptimi i reformave substanciale do t'i shërbejë perspektivës së qartë europiane të Shqipërisë, duke iu përgjigjur kështu pritshmërive të vendeve anëtare të Bashkimit Europian.

26–28 maj: vizitë zyrtare e nënkryetarit të Asamblesë Kombëtare Popullore të Kinës, z. Ji Bing Xuan (*Ji Bingxuan*). Gjatë kësaj vizite Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, zoti Ilir Meta, nënvizoi rëndësinë që Republika Popullore e Kinës u jep marrëdhënieve me Shqipërinë. Zoti Meta theksoi se marrëdhëniet diplomatike të vendosura 67 vjet më parë mes dy vendeve përbëjnë një bazë e fortë për zgjerimin e bashkëpunimit dypalësh në të gjitha drejtimet dhe se kjo vizitë është tregues i marrëdhënieve gjithnjë e më të ngushta ndërparlamentare mes dy vendeve tona mike.

Dy homologët vlerësuan zgjerimin e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Kinës gjatë viteve të fundit si në planin politik, ashtu dhe në atë ekonomik e tregtar.

10–14 tetor: Vizitë zyrtare e Kryetares së Dhomës së Italisë, znj. Laura Boldrini.

Në këtë takim Kryetari i Kuvendit shprehu mirënjohjen për mbështetjen e pakursyer dhe të vazhdueshme që Italia i jep Shqipërisë në kuadër të avancimit të procesit të integrimit europian. Zoti Meta theksoi se Italia është avokatja më e fuqishme e Shqipërisë në procesin e integrimit në Bashkimin Europian, si dhe shprehu bindjen se dy parlamentet duhet të intensifikojnë edhe më shumë bashkëpunimin e tyre veçanërisht për çështjet e përafrimit të legjislacionit dhe për rritjen e rolit mbikëqyrës së Kuvendit.

Gjatë takimit zoti Meta dhe zonja Boldrini vlerësuan bashkëpunimin e ngushtë dhe asistencën italiane në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme, si dhe shprehën bindjen se dy parlamentet mbështesin intensifikimin e këtij bashkëpunimi vital mes dy qeverive për të luftuar rrjetet kriminale.

22–23 qershor: vizitë zyrtare e Kryetarit të parlamentit të Malit të Zi, zotit Darko Pajović. Gjatë takimit të zhvilluar në Tiranë dy kryeparlamentarët vlerësuan marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy vendeve tona. Ata ranë dakord për intensifikimin dhe konkretizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes dy parlamenteve në funksion të integrimit europian dhe avancimit të projekteve strategjike rajonale. Gjatë takimit dy homologët Meta dhe Pajović vunë në dukje se marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Malit të Zi janë një model i shkëlqyer i fqinjësisë së mirë për gjithë rajonin.

18–20 nëntor: vizitë zyrtare e Presidentes së Këshillit Kombëtar të Konfederatës së Zvicrës, zonjës Christa Markwalder. Në këtë vizitë Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, zoti Ilir Meta, vlerësoi marrëdhëniet midis dy vendeve tona, të cilat i cilësuar të veçanta falë pranisë tepër domethënëse të komunitetit shqiptar në këtë vend mik si dhe në kuadër të gjithë vlerave që Shqipëria dhe Zvicra ndajnë së bashku si dy vende demokratike dhe si dy vende të interesave të përbashkëta. Gjatë takimit dy homologët diskutuan për forcimin e mëtejshëm të shkëmbimeve parlamentare midis dy vendeve tona si dhe shprehën bindjen për dobinë e forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve dhe konkretizimit të bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë.

Shkëmbimet e vizitave dypalëshe në kuadër të delegacioneve nga komisionet parlamentare gjithashtu kanë qenë mjaft intensive. **Janë realizuar jashtë Shqipërisë 5 vizita:**

1. Takim i Komisionit të Sigurisë Kombëtare me homologë në Londër.
2. Vizitë zyrtare e Grupit të Miqësisë Shqipëri–Gjermani në Berlin.
3. Pjesëmarrje në një aktivitet të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese të zhvilluar në Greqi.
4. Takim ndërmjet Komisionit të Integrimit të Kuvendit të Shqipërisë me homologë të Kuvendit të



Kosovës.

5. Takim ndërmjet Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese të Kuvendit të Shqipërisë me homologët në Bavari.

Janë realizuar **7 vizita të delegacioneve nga komisionet parlamentare të vendeve të huaja me homologë në Kuvendin e Shqipërisë:**

1. Vizita e kryetares së Komisionit të Jashtëm të Asamblesë Kombëtare të Francës, znj. Elisabeth Guigou.

2. Vizitë e Komisionit parlamentar për Politikën e Jashtme të Republikës së Bullgarisë në Tiranë.

3. Vizitë e Komisionit parlamentar për Politikën e Jashtme të Republikës së Çekisë në Tiranë.

4. Vizitë e një përfaqësie të Komisionit për Çështjet Europiane të Bundestagut gjerman, të kryesuar nga z. Manuel Sarrazin, njëkohësisht raportues për Maqedoninë dhe Shqipërinë.

5. Vizitë e një përfaqësie nga Komisioni për Çështje Europiane të Asamblesë Kombëtare të Francës, kryesuar nga znj. Danielle Auroi, në Komisionin e Integritetit.

6. Vizitë e një përfaqësie të Komisionit për Legjislacion, Mandatet, Imunitetet, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit nga Kuvendi i Kosovës.

B. Aktivitete në kuadër të organizatave shumëpalëshe

Pjesëmarrja në aktivitete shumëpalëshe gjatë vitit 2016 ka qenë shumë e gjerë dhe Kryetari i Kuvendit ka marrë pjesë në 3 aktivitete:

15 prill: vizitë zyrtare e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Split.

Gjatë kësaj vizite zoti Meta mori pjesë në Konferencën e 14-të të Kryetarëve të Parlamenteve të Nismës Adriatiko-Joniane. Kryetari i Kuvendit në këtë rast mbajti një fjalim, ku vuri në dukje se vendet e Nismës Adriatiko-Joniane, veçanërisht ato të Ballkanit, në dobi të zhvillimit, e kanë lënë pas të shkuarën e tyre, duke u përpjekur kështu të përfitojnë sa më shumë nga integrimi rajonal.

22 maj: vizitë zyrtare e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Luksemburg.

Gjatë kësaj vizite zoti Meta mori pjesë në Konferencën e Kryetarëve të Parlamenteve të vendeve të BE-së. Në konferencë ishte i pranishëm edhe Presidenti i Komisionit Europian, z. Jean Claude Juncker dhe Shqipëria ftohej të merrte pjesë në këtë aktivitet të rëndësishëm për herë të dytë, si vend kandidat për në BE. Gjatë punimeve të konferencës zoti Meta zhvilloi takime dypalëshe me Presidentin e Senatit të Francës, z. Gerard Larcher, Kryetarin e Dhomës së Përfaqësuesve të Luksemburgut, z. Mars Di Bartolomeo, Kryetaren e Senatit të Vendeve të Ulëta, znj. Ankie Broekers-Knol, Kryetaren e Dhomës së Përfaqësuesve të Vendeve të Ulëta, znj. Khadija Arib, Kryetarin e Parlamentit të Portugalisë, z. Eduardo Ferro Rodrigues, Kryetarin e Parlamentit të Suedisë, z. Urban Ahlin, Kryetaren e Parlamentit të Danimarkës, znj. Pia Kjaersgaard, Kryetarin e Asamblesë Kombëtare të Francës, z. Claude Bartolone, Presidentin e Bundestagut gjerman, z. Norbert Lamert, Kryetaren e Dhomës së Deputetëve të Italisë, znj. Laura Boldrini, Kryetarin e Parlamentit të Maltës, z. Angelo Farrugia, Kryetarin e Sejmit të Polonisë, z. Marek Kuchcinski, Kryetaren e Parlamentit të Zvicrës, znj. Christa Markwalder dhe me Kryetarin e Kongresit të Deputetëve të Spanjës, z. Patxi Lopez Alvarez. Në këto takime me homologët e tij Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë bisedoi për intensifikimin e bashkëpunimit ndërparlamentar, ecurinë e reformave në Shqipëri, forcimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe situatën në rajon.

17–18 nëntor: vizitë zyrtare e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë në Baden të Gjermanisë, pjesëmarrës në Konferencën Ekonomike të Bizneseve Familjare.



Kuvendi i Shqipërisë ka realizuar disa aktivitete në kuadër të bashkëpunimit të organizatave shumëpalëshe dhe bashkëpunimit rajonal, si më poshtë:

- 18–19 shkurt: Asambleja Parlamentare e vendeve të Mesdheut;
- 26–28 prill: konferencën vjetore e grave parlamentare të rajonit;
- 19–20 maj: takimi i 10-të i Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri (KPSA);
- 8–9 prill: Komisioni i Përgjithshëm për Zhvillimin Social, Edukimin, Kërkimin dhe Shkencën i Asamblesë Parlamentare të SEECP-së;
- 27–30 maj: Asambleja Parlamentare e NATO-s;
- 22–23 shtator: takimi i Komisionit për Respektimin e Detyrimeve dhe Angazhimeve nga vendet anëtare të Këshillit të Europës (Komision Monitorues).



Delegacionet e përhershme të Kuvendit të Shqipërisë pranë organizatave ndërkombëtare kanë marrë pjesë në sesionet parlamentare dhe në mbledhjet e komisioneve të përhershme të organizatave ku vendi ynë është anëtar, si: NATO, OSCE, APKiE, SEECP, PABSEC, PAM, NAJ, IPU, CEI, AP Ortodoksisë etj.

Sipas rregullores, gjatë këtij viti u zhvilluan edhe 2 takimet vjetore: takimi i 10-të dhe i 11-të i Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri (SACP).

Gjithashtu në vitin 2016 deputetë dhe përfaqësues të administratës së Kuvendit të Shqipërisë kanë marrë pjesë në disa aktivitete, konferenca dhe seminare të zhvilluara nga Njësia e Përafrimit pranë Parlamentit Europian me tema nga më të ndryshmet, si: “Mosdiskriminimi i personave me aftësi të kufizuara në vendet e zgjerimit të BE-së”; “Politikat e BE-së për azilin dhe emigracionin, implikimet e parlamenteve të vendeve në zgjerim”; “Ndërveprimi i grupeve parlamentare, partive dhe qeverisë në procesin e pranimit në Bashkimin Europian”; “Gratë refugjate dhe azilkërkuese në BE”.

C. Aktivitete të aspektit protokollar dhe të Shërbimit të Përkthimit

Në përmbushjen e objektivave të veprimtarisë së marrëdhënieve me jashtë të Kuvendit të Shqipërisë kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm dy strukturat e tjera, pjesë të Shërbimit të Marrëdhënieve me Jashtë. Stafi i këtyre dy sektorëve përveç detyrave të përcaktuara në përshkrimet punës janë angazhuar në ndjekjen e praktikave dhe organizimin e aktiviteteve të Shërbimit të Marrëdhënieve me Jashtë të Kuvendit, duke kontribuar në realizimin me sukses të tyre.



Drejtoria e Protokollit

Protokolli i Kuvendit të Shqipërisë është struktura e ngarkuar me detyrën e zbatimit të ceremonialit të brendshëm të këtij institucioni, të aktivitetit parlamentar dhe rregullimin e aspekteve të ndryshme të marrëdhënieve me trupin diplomatik, të marrëdhënieve publike të institucionit dhe takimet e parlamentarëve me delegacionet e huaja (VKM nr. 229, datë 23.04.2004, *Fletore zyrtare* nr. 29 14.05.2004)

Angazhimi i Drejtorisë së Protokollit gjatë vitit 2016 ka qenë në përgatitjen nga ana protokollare dhe e ceremonialeve të takimeve të kortezisë, të aktiviteteve të ndryshme nën kujdesin e Kryetarit të Kuvendit, zotit Ilir Meta, dhe të vizitave zyrtare të personaliteteve të nivelit të lartë. Mbështetja e kësaj drejtorie lidhet jo vetëm me pritjen dhe përcjelljen, por edhe me ndjekjen e praktikave, siç është përgatitja e programit, koordinimi dhe organizimi i takimeve në bashkëpunim me ambasadat përkatëse.

Pas miratimit të programit nga Kryetari i Kuvendit është vijuar me përgatitjen e kërkesave për takime, kërkesa për dreka apo darka zyrtare, kërkesave për akomodime në hotele, kërkesave për sigurimin e mjeteve të transportit, njoftimet e të ftuarve (përgatitjen e ftesave dhe marrjen e konfirmimeve), përgatitjen e dhuratave dhe shkëmbimin protokollar, ndjekjen dhe shoqërimin e delegacionit gjatë ditëve të qëndrimit (pritje e përcjellje në aeroport) dhe më pas realizimin e gjitha shërbimeve sipas programeve përkatëse të secilit delegacion apo aktivitet.

Njësia e Përkthimit

Gjatë vitit 2016, në përgjigje të kërkesave dhe nevojave të Kryetarit të Kuvendit dhe kabinetit, të komisioneve parlamentare dhe të shërbimeve të ndryshme të Kuvendit, njësia e përkthimit ka përmbushur detyrimet e saj duke përkthyer 541 faqe materiale të përcjella nga shërbime të ndryshme të Kuvendit të Shqipërisë. Ky sektor gjithashtu ka kryer dhe ka ndjekur praktika të përkthimit simultan dhe konsektiv në 15 takime dhe konferenca të ndryshme në Kuvendin e Shqipërisë.

Njësia e Përkthimit ka asistuar Shërbimin e Marrëdhënieve me Jashtë përmes hartimit të letrave zyrtare të Kryetarit të Kuvendit drejtuar homologëve, ndjekjes së realizimit të 7 praktikave, hartimit të notave zyrtare dhe angazhimit në aspektin protokollar të aktiviteteve të ndryshme. Gjithashtu ka dhënë një kontribut të gjerë në kuadër të organizimit të Asamblesë Parlamentare të Mesdheut (PAM) dhe organizimit të Sesionit të Pranverës të Asamblesë Parlamentare të NATO-s (NATO-PA).



Kapitulli 6

TRANSPARENCA PARLAMENTARE

Kuvendi i Shqipërisë edhe gjatë vitit 2016 ka vijuar punën për të përmirësuar më tej transparencën, duke vijuar punën në drejtim të rritjes së perceptimit për një parlament pranë dhe në kontakt me qytetarin si dhe përmirësimin e marrëdhënieve të tij me publikun.

Transparenca nuk është vetëm një parim themelor mbi të cilin duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre institucionet shtetërore në tërësi, por mbi të gjitha është një domosdoshmëri, e cila u mundëson qytetarëve të informohen, të monitorojnë, madje të kontrollojnë veprimtarinë dhe punën e institucioneve, duke i siguruar publikut një mënyrë për t'u përfshirë në procesin e vendimmarrjes. Për këtë arsye një vëmendje e posaçme i është kushtuar nxitjes dhe forcimit të komunikimit me publikun.

1. Parlamenti dhe publiku

Pjesëmarrja e publikut në procesin vendimmarrës është dëshmi e një sistemi politik demokratik, i cili vjen si një angazhim i dyanshëm: partnerët socialë, shoqëria civile dhe grupet e interesit, nga njëra anë, dhe Kuvendi, nga ana tjetër.

Kuvendi i Shqipërisë ka ndërmarrë hapa konkretë, që i shërbejnë realizimit të bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe Kuvendit, por dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë civile për rolin e dobishëm që ka në procesin vendimmarrës.




Thirrje për regjistrim OSHC-ve

Gjatë vitit 2016 janë realizuar disa forma inkurajimi dhe bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile dhe Kuvendit. Me rifillimin e veprimtarisë parlamentare në sesionin e dytë, shtator–dhjetor 2016, në faqen zyrtare të Kuvendit: <https://www.parlament.al/>, u publikua “*Thirrje për regjistrim OSHC-ve*”. Kjo thirrje u konceptua si një alternativë dhe ftesë për shoqërinë civile për t'u bërë pjesë e regjistrimit elektronik, i cili administrohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

Thirrja apo ftesa drejtuar shoqërisë civile ka qenë publike për dy muaj (5 shtator–31 tetor 2016). Kjo thirrje nënkupton risjelljen në vëmendje të shoqërisë sonë demokratike se ka forma dhe mundësi që na lehtësojnë dhe mundësojnë bashkëpunimin e ndërsjellë. Gjatë publikimit të thirrjes interesimi për të qenë pjesë e regjistrimit elektronik të OSHC-ve është shprehur nga disa organizata, por periudha shtator–tetor ka pasur nivelin më të lartë të kërkesave për regjistrim në krahasim me periudhat e tjera të vitit.

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme shprehin interesin e shoqërisë civile dhe të grupeve të interesit, në cilat komisione parlamentare ato e shohin organizatën e tyre më të interesuar dhe të fokusuar për të dhënë sugjerimet e përkatëse.



Në kuadër të angazhimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për inkurajimin e zhvillimit të një shoqërie civile të shëndetshme si dhe vendosjen e një dialogu të përhershëm mbi baza besimi reciproke ndërmjet institucionit dhe qytetarëve, janë organizuar dy forume me temë: “*Forcimi i rolit dhe bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe parlamentit*”.

Këto dy forume janë zhvilluar në dy qarqe të Shqipërisë: Dibër dhe Kukës. Forumi i parë u zhvillua datë 14.10.2016 në qytetin e Bulqizës, i radhës më datë 18.11.2016 në qytetin e Kukësit.

Në takimin e zhvilluar në qytetin e Bulqizës morën pjesë deputetët e qarkut të Dibrës. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri u përfaqësua nga shefja e Departamentit të Demokratizimit dhe *New Senior Democratization Officer*. Të ftuar ishin përfaqësues të shoqërisë civile dhe të grupeve të interesit në qarkun e Dibrës.

Sikurse në qytetin e Kukësit morën pjesë deputetët e qarkut Kukës dhe përfaqësuesit e Shoqërisë Civile dhe Grupeve të Interesit të qarkut në fjalë. Vlen për t’u theksuar fakti se realizimi i këtyre forumeve është vlerësuar si nga deputetët por edhe nga vetë shoqëria civile, për krijimin e mundësisë së komunikimit direkt dhe afërimit të ndërsjellë.

Në kuadër të bashkërendimit të punës me universitetet dhe drejtoritë mësimore për zbatimin e programeve që kanë për qëllim njohjen e studentëve dhe të nxënësve me veprimtarinë e Kuvendit, janë zbatuar projekte të ndryshme, edhe në bashkëpunim me OSBE-në, për organizimin dhe krijimin e urave lidhëse midis qytetarëve me Kuvendin, “*Building a bridge between parliament and civil society*”, ku u është dhënë prioritet procedurave lehtësuese të pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes si dhe në pjesëmarrjen e studentëve në ambientet e ndryshme të Kuvendit të Shqipërisë, duke e bërë sa më transparente punën administrative të këtij institucioni.

Kuvendi i Shqipërisë ka iniciuar nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me disa universitete në rang Republike, të cilat janë në proces. Në datën 13 dhjetor 2016 Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, dhe rektori i Universitetit të Tiranës, z. Mynyr Koni, në një ceremoni të posaçme nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit mes Kuvendit të Shqipërisë dhe Universitetit të Tiranës. Të pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, që u zhvillua në ambientet e Rektoratit, ishin akademikë, pedagogë, Sekretarja e Përgjithshme e Kuvendit, zonja Albana Shtylla, deputeti Fatmir Toçi, drejtues të shërbimeve të Kuvendit, studentë etj. Në fjalën e tij të rastit Kryetari i Kuvendit vlerësoi nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, të cilën e cilësoi shumë produktive.

Në fillim të vitit 2016 Kuvendi i Shqipërisë publikoi faqen e re zyrtare të tij, e cila ka ardhur me një dizajn që ruan identitetin institucional, por me parametra teknike bashkëkohor. Tashmë kjo faqe mundëson një motor kërkimi të avancuar dhe mjaft të organizuar, një arkiv historik të pasuruar, standarde bashkëkohore të funksionimit dhe të dizajnit etj.

Një dritare e posaçme në faqen e re zyrtare i është kushtuar transparencës parlamentare, ku qytetarët



mund të marrin gjithë informacionin e nevojshëm mbi funksionimin e Kuvendit të Shqipërisë, por edhe për procedurat që duhen ndjekur për të qenë pjesëmarrës aktivë në veprimtaritë parlamentare. Implementimi i formularëve elektronikë në këtë dritare për pjesëmarrje në veprimtaritë e Kuvendit të Shqipërisë e kanë lehtësuar së tepërmi komunikimin me individët, shoqëritë dhe organizatat e ndryshme dhe grupet e interesit. Evidencat dëshmojnë se numri i vizitorëve në Kuvendin e Shqipërisë gjatë vitit 2016 është trefishuar në krahasim me një vit më parë.

Me qëllim përmirësimin e cilësisë së procesverbaleve të seancave plenare dhe atyre në komisioneve, si dhe për publikimin e tyre në kohë, sipas rregulloreve në fuqi, në faqen zyrtare të internetit janë rritur dhe përmirësuar kapacitetet në mbështetje të procesit të redaktimit.


Me qëllim nxitjen dhe mbështetjen e qytetarëve në kërkesën dhe interesin e tyre për veprimtarinë parlamentare dhe, ç'është më e rëndësishmja, për të nxitur dhe mundësuar në një kohë sa më të shpejtë përthithjen e mendimit dhe të perceptimit qytetar, të shoqërisë civile dhe të grupeve të interesit lidhur me projektligje gjatë shqyrtimit të tyre në Kuvendin e Shqipërisë, në një vend të dukshëm në *home page* të faqes zyrtare të Kuvendit është një dritare e posaçme *E-Democracy*, ku aktualisht është publikuar një formular, përmes plotësimit të të cilit qytetarët dhe gjithë të interesuarit mund të japin mendimet, komentet e tyre, të cilat në mënyrë automatike u përcillen personave përgjegjës për trajtimin e tyre, siç janë koordinatorja për të drejtën e informimit në Kuvendin e Shqipërisë dhe koordinatorja për shoqërinë civile. Po ashtu përmes elementeve vizuale (ikona, foto dhe video), faqja e re zyrtare e Kuvendit thekson të gjithë informacionin e nevojshëm mbi projektligjet, seancën plenare, programin e punës dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit, si dhe të gjithë dokumentacionin parlamentar lidhur me to. Një kujdes i posaçëm është treguar për informacionin dhe njohuritë mbi Kuvendin e Shqipërisë që u përçohen grupmohave të reja përmes faqes zyrtare të Kuvendit.

Sa i përket trajtesës së kërkesave drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, përfshirë edhe ato për informacionin dhe dokumentacionin, evidencat dëshmojnë se qytetarët kanë marrë përgjigje orientuese, informuese si dhe këshillim ligjor për çështjet e përcjella me shkrim pranë strukturave të posaçme të këtij institucioni sipas legjislacionit në fuqi, rregulloreve dhe procedurave institucionale po ashtu.

Në funksion të rritjes së transparencës ndaj publikut gjatë gjithë vitit 2016 ka vijuar me rigorozitet përditësimi i programit të transparencës i Kuvendit të Shqipërisë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës institucioni ynë ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij. Informacioni i bërë publik në këtë program synon të bëjë transparent veprimtarinë e punës së Kuvendit të Shqipërisë përmes paraqitjes së detajuar të tij dhe lehtësisht të kuptueshme në faqen zyrtare www.parlament.al si dhe në mjediset e institucionit. Ky program është ndërtuar në mënyrë të tillë që mundëson dhënien e informacionit për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.



Paraqitja grafike krahasuese e shkresave për periudhën 2015–2016



Evidenca krahasuese e shkresave sipas kategorive për periudhën 2015–2016

	Muaji	<i>Kartela*</i>		<i>Kthim përgjigje</i>		<i>Fletëhyrje</i>		<i>Pritja e qytetarëve</i>	
		2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015
1	Janar	43	28	24	18	308	135	14	26
2	Shkurt	64	54	30	27	66	89	12	20
3	Mars	62	60	28	42	109	475	14	16
4	Prill	43	70	24	34	611	353	19	17
5	Maj	52	79	27	50	1833	305	15	12
6	Qershor	62	54	32	40	64	132	18	35
7	Korrik	43	45	26	21	9	16	11	17
8	Gusht	41	25	28	12	2	0	14	0
9	Shtator	45	60	20	21	265	48	12	32
10	Tetor	40	54	22	26	281	58	17	29
11	Nëntor	60	61	28	23	2664	166	16	42
12	Dhjetor	52	43	9	26	242	260	21	27
	Gjithsej	607	618	298	327	6454	2187	183	273

1. Parlamenti dhe media

Parlamenti dhe media janë dy aktorë të rëndësishëm në një demokraci funksionale. Nisur nga ky përcaktim faktik, ndërtimi i marrëdhënieve të forta, cilësore dhe profesionale me medien, të bazuara në parimin e transparencës, objektivitetit dhe të paanshmërisë është objektivi i synuar gjatë vitit 2016.



Në përmbushje të këtij synimi, Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun e ka mbështetur aktivitetin e tij në pasqyrimin e axhendës së aktiviteteve parlamentare në kohë dhe me saktësi, në organizimin e punës për njoftimin, komunikimin, akreditimin dhe mbështetjen e gazetarëve, me qëllim informimin e tyre mbi veprimtaritë parlamentare. Shërbimi bashkëpunon me medien për t'iu përgjigjur kërkesave të tyre për informacion dhe dokumentacion, si dhe kërkesave të tjera të tyre ndaj strukturave parlamentare. Pavarësisht kohëzgjatjes dhe tendencës gjithnjë në rritje të punës në komisione dhe në seancë plenare, stafi i këtij Shërbimi është përpjekur që t'iu përgjigjet me përkushtim kërkesave dhe të përmbushë detyrat e tij në funksion të transparencës parlamentare. Vlen të përmendet se gjatë vitit 2016 Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun ka ndjekur dhe pasqyruar në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në medie lajmet mbi reformën në drejtësi si dhe dy aktivitetet e rëndësishme ndërkombëtare që janë zhvilluar në vendin tonë (PAM–NATO), sipas standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Media shqiptare, por dhe të huaja, kanë pasqyruar në mënyrë të kënaqshme punimet e Asamblesë Parlamentare të NATO, që u mbajt më 27–30 maj 2016 në Tiranë.

Gjatë vitit 2016 janë ndjekur mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe seancat plenare, Konferenca e Kryetarëve, mbledhjet e Byrosë, etj., si dhe janë organizuar konferenca për shtyp të Kryetarit të Kuvendit, zotit Ilir Meta, dhe të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, të cilat përmes njoftimeve për shtyp dhe fotove ilustruese janë pasqyruar në faqen zyrtare të Kuvendit: www.parlament.al. Të dhënat e një analize krahasuese për dy vjetët e fundit (2015–2016) dëshmojnë se numri i mbledhjeve të komisioneve parlamentare dhe seancave plenare të ndjekura dhe të pasqyruara nga Shërbimi në faqen e internetit dhe të komunikuar në medie është rreth 800 njoftime, dukshëm më i lartë se ai i vitit 2015.



Gjithashtu materialet e publikuara *on-line* janë përkthyer në kohë reale në gjuhën angleze dhe janë publikuar në seksionin anglisht po në faqen zyrtare të internetit. Gjatë vitit 2016 janë akredituar rreth 332 përfaqësues të medieve dhe 170 punonjës teknik.

2. Kërkimi Parlamentar dhe Biblioteka

Shërbimi i Kërkimit Parlamentar dhe Biblioteka sigurojnë një gamë të gjerë informacioni për deputetët dhe stafin e tyre mbështetës nëpërmjet ofrimit të shërbimit të referencës së librit, dokumentacionit parlamentar dhe bazave të të dhënave që ai disponon, me qëllim mbështetjen e tyre përmes informacionit për realizimin e detyrave gjatë procesit legjislativ dhe përfaqësues.



Kërkimi Parlamentar

Në vitin 2016 Shërbimi i Kërkimit Parlamentar ka hartuar 142 produkte kërkimore (86 materiale informuese, informacion krahasues, studime dhe 25 me vetiniciativë, 56 produkte informuese nga ECPRD), duke mbështetur punën e komisioneve parlamentare.



Të dhënat statistikore dëshmojnë se gjatë vitit 2016 ka një rritje sasiore të produkteve të kërimit parlamentar në përgjigje të kërkesave të deputetëve në krahasim me vitin 2015, por vlen të theksohet edhe një rritje cilësore e dukshme duke u bazuar në këto aspekte:

1. Burimet e informacionit (referencat)
2. Tematikat e produkteve kërkimore dhe mënyra e realizimit të tyre
3. Shumëllojshmëria e produkteve




Për sa i përket bazës së të dhënave *ProLigj* – retrospektivë në vitin 2016 është krijuar baza e re për *Fletoret zyrtare* të vitit 1920–1939 dhe 1940–1945.

Biblioteka dhe Periodiku

Biblioteka kryen zhvillimin dhe organizimin e vazhdueshëm të burimeve të informacionit, në mënyrë që të sigurojë dhënien sa më të saktë e të shpejtë në funksion të procesit legjislativ.

Gjatë vitit 2016 Biblioteka u pasurua me 64 libra bashkëkohorë në gjuhë të huaj të blerë për këndin e BE-së.





Në fond dhe në sallën e periodikut rezulton se janë gjendje 95 tituj, prej të cilëve: 54 tituj koleksionesh me gazeta, revista, *Fletore zyrtare*, punime të Kuvendit si dhe 41 tituj revista dhe gazeta jashtë koleksioneve.

3. Botimet Parlamentare

Në vitin 2016 nga **Shërbimi i Botimeve Parlamentare** janë përgatitur dhe çuar në shtypshkronjën e Kuvendit “Punimet e Kuvendit” deri në fund të vitit 2015. Gjithashtu janë përgatitur dhe botuar dy numra të revistës “Kuvendi”, vëllimi “25 vjet parlament pluralist demokratik” në kuadër të 25-vjetorit të parlamentit dhe u përfundua botimi i rilidhur i kolanës së “Bisedimeve parlamentare” për vitet 1924–1939.

Spektori i Redaktorëve ka punuar për zbardhjen dhe redaktimin e seancave plenare, të komisioneve të përhershme, të përkohshme, të posaçme dhe hetimore parlamentare, të mbledhjeve të Këshillit Kombëtar të Integritetit Europian, të Këshillit të Mandateve dhe Imuniteteve, të Komisionit për Reformën në Drejtësi, si dhe të disa mbledhjeve të Konferencës së Kryetarëve e të Byrosë Parlamentare.





4. Teknologjia e Informacionit

Viti 2016 ka qenë i orientuar drejt realizimit të dy projekteve të rëndësishme për Kuvendin e Shqipërisë. Së pari, ideimi dhe implementimi i sistemit audio-video në mjediset e Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë sipas mbështetjes financiare nga fondet IPA për implementimin e këtij sistemi, i cili pritet të realizohet gjatë vitit 2017.

Kuvendi i Shqipërisë ka ndërtuar dhe ka implementuar përmes **Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit faqen e re të internetit, të përgatitur për bërjen publike për përdoruesit në 1 shkurt 2016**. Faqja e re *on-line* mundëson akses më të lehtë kërkimi dhe informacioni jo vetëm për stafin e Kuvendit, por dhe për qytetarët. Nëpërmjet kësaj faqeje janë sjell disa risi, në mënyrë që dokumentet parlamentare të jenë të lehta për t'u aksesuar. Përveç kësaj janë ngritur rubrika të veçanta, ku është bërë e mundur që qytetarët të aplikojnë direkt për të ndjekur nga afër punimet e seancave plenare dhe të komisioneve parlamentare. Nëpërmjet kësaj faqeje Kuvendi ka bërë të mundur edhe rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në jetën parlamentare, duke i lehtësuar edhe më shumë procedurat dhe duke i bërë më të dukshme nismat ligjore që shqyrton komisioni. Qytetarët e kanë më të lehtë të kontaktojnë me deputetin e tyre, pasi në faqen kryesore ata mund të klikojnë direkt dhe t'i shkruajnë deputetit në adresën e tij personale. Po ashtu nëpërmjet faqes së re të internetit qytetarët do të kenë mundësi të dërgojnë *on-line* kërkesat, ankesat, vërejtjet etj., gjë që rrit në mënyrë të dukshme transparencën parlamentare.

Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit njëkohësisht me publikimin e faqes së re zyrtare të internetit të Kuvendit ka mundësuar edhe kalimin e të gjitha adresave të imeilit zyrtar të Kuvendit punonjësve të administratës dhe deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë në serverin e ri “EXCHANGE”. Më parë ky shërbim sigurohej nga kompani jashtë Kuvendit. Kjo u arrit duke pasur një sërë komunikimesh me AKSHI-n dhe AKEP-in për të siguruar DNS publike. Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit ka arritur të bëjë kalimin brenda një kohe shumë të shkurtër, duke punuar paralelisht si në pajisjet serverë në dhomën e serverave, duke krijuar dhe konfiguruar të gjitha adresat si dhe duke asistuar (duke bërë konfigurimin në çdo kompjuter) çdo punonjës të Kuvendit. Kalimi është bërë pa shkaktuar probleme apo humbje të imeileve që ka pasur stafi.

Gjatë vitit 2016 është intensifikuar puna dhe është shtuar numri i përdoruesve të platformës *E-parlament*. Janë bërë testimet e sistemit nga të gjitha shërbimet që kanë rol në sistem. Nga Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit gjatë 2016 janë zhvilluar trajnime për deputetët dhe është zhvilluar administrimi, mirëmbajtja në proceset rutinë të aplikimit, duke dhënë suport për *user-at* gjatë gjithë fazës së trajnimit dhe fillimit të punës. Në shtator 2016 ka filluar funksionimi i sistemit sipas Rregullores së Kuvendit. Janë krijuar të gjithë përdoruesit sipas roleve të tyre dhe deri tani janë instaluar afërsisht 40 certifikata të nevojshme për përdoruesit miratues në sistem.

Po ashtu është përgatitur një faqe për përdorimin e dokumenteve të brendshme të stafit të Kuvendit (intranet). Kjo faqe përveç rregulloreve, dokumenteve të ndryshme të publikuara në të është krijuar në formë kontakti, ku të gjithë punonjësit e Kuvendit pa përjashtim mund të lidhen me Shërbimin e Teknologjisë së Informacionit për problemet që hasin gjatë punës së tyre dhe një person nga Help Desk do të jetë i disponueshëm, pasi kërkesat e tyre do të vijnë nëpërmjet imeilit.

Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit ka dhënë kontribut të qenësishëm në organizimin e aktivitetit parlamentar të Asamblesë Parlamentare të NATO-s (27–30 maj 2016). Gjatë vitit 2016 është hartuar dhe miratuar në Byronë e Kuvendit rregullorja e brendshme për administrimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe programeve të teknologjisë së informacionit në Kuvendin e Shqipërisë dhe protokollin e punës për çdo shërbim. Ndër detyrat e tjera të zhvilluara janë dhe administrimi i sistemit *Infopoint* të Kuvendit, krijimi dhe plotësimi i regjistrit të IT, mirëmbajtja e sistemeve audio-video, administrimi dhe mirëmbajtja e *Active Directory* dhe imeilit zyrtar të Kuvendit, arkivimi i regjistrimeve audio dhe video i seancave plenare etj.



Kapitulli 7

ADMINISTRIMI

1. Financa dhe buxheti

Hartimi i buxhetit. Në vitin 2016 Shërbimi i Financës ka koordinuar punën për përgatitjen e dokumentit të PBA-së 2017–2019 dhe e ka percjellë atë në Ministrinë e Financave brenda afateve ligjore. Me qëllim realizimin e objektivave institucionale, dokumenti i PBA-së u përgatit mbi bazën e kërkesave të argumentuara për secilin shërbim dhe u shoqërua me pasqyrat e kërkesave shtesë dhe relacionin sqarues të nevojshëm. Në zbatim të neneve 10 dhe 11 të Rregullores së Kuvendit, projektbuxheti, i shoqëruar me analizën dhe argumentet përkatëse, u është bërë me dije paraprakisht Sekretariatit për Buxhetin dhe Byrosë së Kuvendit. Gjithashtu u hartua buxheti për vitin 2017, si pjesë integrale e buxhetit të shtetit, i cili akordohet me ligjin vjetor të buxhetit. Ky buxhet përbën afërsisht 0.3% të buxhetit të shtetit dhe vlerësohet për mundësimin e realizimit me sukses të objektivave vjetorë të institucionit, duke u ndarë në dy programe buxhetore.

Hartimi i buxhetit u realizua duke pasur parasysh:

- Rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të menaxhimit të shpenzimeve publike.
- Mundësimin e plotësimit të nevojave buxhetore në realizimin e politikave të programeve.
- Përfshirjen e menaxherëve të lartë të institucionit në procesin e vlerësimit të nevojave dhe të zbatimit të buxhetit.
- Orientimin e shpenzimeve në ato drejtime që vlerësohen si prioritete për politikën e programit.


Gjatë vitit 2016 buxheti i Kuvendit ka ndryshuar me dy aktet normative me kërkesën e vetë institucionit.



Plani buxhetor vjetor me ndryshimet e bëra gjatë vitit:

Kod institucioni	Emërtimi	Miratuar sipas ligjit nr. 147/2015	Sipas aktit normativ nr. 1	Sipas aktit normativ nr. 2
Programi legjislativ				
1002001	Pagat	332.000.000	332.000.000	313.000.000
	Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	47.000.000	47.000.000	44.000.000
	mallra e shërbime	287.400.000	277.400.000	271.400.000
	Transferta korrente të huaja	13.600.000	13.600.000	13.600.000
		680.000.000	670.000.000	642.000.000
Programi, planifikim, menaxhim, administrim				
	Pagat	197.000.000	197.000.000	180.000.000
	Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	33.000.000	33.000.000	30.000.000
	Mallra e shërbime	251.000.000	184.700.000	173.700.000
	Transferta korrente të huaja	0	0	0
		481.000.000	414.700.000	383.700.000
		1.161.000.000	1.084.700.000	1.025.700.000

Pesha specifike e secilës llogari ekonomike të planifikuar mbi totalin paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Drejtorja e Financës dhe Buxhetit administroi dhe menaxhoi fondet publike të ndara në dy programe buxhetore: 1) veprimtaria legjislativë; 2) menaxhimi dhe administrimi.



Realizimi për secilin program paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Programi	Emërtimi	Fondi	Realizuar	Përqindja e realizimit
01120 Program legjislativ				
	Pagat	313.000.000	304.920.036	97
	Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	44.000.000	34.503.931	78
	mallra e shërbime	271.400.000	269.842.964	99
	Transferta korrente te huaja	13.600.000	12.057.275	89
	Shuma	642.000.000	621.324.206	97
01110 Program, planifikim, menaxhim, administrim				
	Pagat	180.000.000	177.474.255	99
	Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	30.000.000	28.155.462	94
	Mallra e shërbime	173.700.000	136.348.502	79
	Shuma	383.700.000	341.978.219	90
	TOTALI	1.025.700.000	963.302.425	94

Nga analiza e realizimit të zërave të shpenzimeve vërehet se:

Zëri i pagave dhe sigurimeve (llogaria ekonomike 600 dhe 601) për programin legjislativ është realizuar në masën **95 %**.

357.000.000 lekë plani – 339.423.967 lekë fakti.

Në realizimin në masën 95% kanë ndikuar:

- Penalitetet ndaj deputetëve për mospjesëmarrje në seanca plenare dhe mbledhjet e komisioneve parlamnetare.
- Masat disiplinore.

Në këtë zë kundrejt planifikimit të akorduar në buxhetin e fillimvitit me vlerë 379.000.000 lekë u krijuan fonde të lira nga:

- Diferenca me 2 deputetë - 140 plani, 138 fakti.
- Struktura e paplotësuar me një këshilltar grupi parlamentar.
- Struktura e paplotësuar me 14 punonjës të zyrave zgjedhore, pasi strukturat vendore nuk janë përgjigjur me ambiente për hapjen e tyre.

Zëri i pagave dhe sigurimeve (llogaria ekonomike 600 dhe 601) për programin administrativ është realizuar në masën **98 %**.

210.000.000 lekë plani – 205.629.717 lekë fakti.

Në realizimin në masën 98% të programit administrativ kanë ndikuar:

- Pagesat për paaftësi të përkohshme (persona me raport).
- Pagesat për lindje, të cilat paguhen nga sigurimet shoqërore, si dhe vendet vakante të paplotësuar.

Për të dyja programet nga zëri “paga dhe sigurime” pas analizave të hollësishme institucionale është kthyer në buxhet me aktin normativ nr.2, datë 16.12.2016, vlera 42.000.000 lekë, me qëllim




mirëpërdorimin e fondeve dhe krijimin e mundësisë së përdorimit të tyre në sektorë të tjerë të ekonomisë.

Shpenzimet operative (llogaria ekonomike 602)

Ky zë përfshin një gamë të gjerë shërbimesh të domosdoshme për mirëfunksionimin e institucionit dhe realizimin e objektivave të të gjitha shërbimeve. Gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2016, në zbatim të legjislacionit, çdo urdhër prokurimi është dërguar në Degën e Thesarit për miratim përpara ekzekutimit, sikundër çdo kontratë e nënshkruar me të tretë është regjistruar në buxhet për të ngurtësuar angazhimet në vlerën e saj, me qëllim moslejimin e ndërrimit të destinacionit të fondeve dhe krijimin e debitorëve. Gjithashtu Shërbimi i Financës ka ndjekur dhe kontribuar në hartimin e gjurmëve të auditimit, duke iu përgjigjur urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave lidhur me procedurat për blerjet me vlerë të vogël dhe të lartë të prokurimeve.

Shpenzimet e këtij grupi (për mallra e shërbime) në vitin 2016 janë realizuar në masën 91% ndaj buxhetit të ndryshuar. Ky grup shpenzimesh përfshin një gamë të gjerë artikujsh, grup artikujsh dhe shërbimesh, të cilat veçohen dhe identifikohen sipas një analize shtatëshifrore.

Grafiku i mëposhtëm jep në përqindje strukturën ndërmjet dy programeve në këtë zë buxhetor:



Siç shihet edhe nga grafiku, programi legjislativ ka një përqindje të lartë në totalin e shpenzimeve për shërbime e mallra. Kjo për arsye se këtu përfshihen kompensimet që marrin deputetët nga statusi i deputetit si dhe të gjitha shpenzimet në funksion të zhvillimit të diplomacisë parlamentare dhe jo vetëm. Vlera faktike e këtyre kompensimeve është 170 milionë lekë, që përbëjnë 63% të shpenzimeve faktike (602) në programin legjislativ ose 43 % të realizimit faktik të shpenzimeve.

Në këtë zë në programin legjislativ kundrejt planifikimit të akorduar në buxhetin e fillimvitit me vlerë 287.400.000 lekë u krijuan fonde të lira nga kursimet në kompensimet financiare të deputetëve, të cilat në planifikim llogariten sipas statusit të deputetit dhe vendimit të Kuvendit nr.114/2014 në zbatim tij, ndërsa në fakt varen nga disa faktorë, si:

- numri i mbledhjeve të komisioneve parlamentare, që nuk ka kapur vlerat maksimale të parashikuara dhe për rrjedhojë dhe honoraret e deputetëve kanë qënë më të ulëta;
- mospjesëmarrja e deputetëve për shkaqe të ligjshme apo të paligjshme shoqërohet me mospagimin e honorarit;
- ditët e dietave brenda vendit, në aktivitetet parlamentare në Tiranë apo në qarqe janë deklaruar



më pak se niveli maksimal që parashikon baza ligjore;

- deputetët nuk kanë paraqitur faturat e hotelit për të tërhequr shpenzimet e akomodimit, siç e parashikon baza ligjore;

- numri i deputetëve që përfitojnë qira banese ka qënë më i vogël se në vitet e kaluara, të cilat janë marrë si bazë në planifikim.

Sipas analizave të bëra, fondet e parashikuara si të përealizueshme janë kthyer në buxhet sipas akteve normative nr.1 dhe nr.2.

Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit

Janë shpenzuar rreth 32 milionë lekë për bileta udhëtimi jashtë shtetit. Gjatë vitit 2016 kanë udhëtuar 418 persona (staf dhe deputetë) në destinacione të ndryshme (130 nga stafi i Kuvendit dhe 288 deputetë).

Kuvendi i Shqipërisë ka realizuar një axhendë mjaft të ngjeshur me aktivitete të shumta për avancimin në axhendën europiane të Shqipërisë dhe në kuadër të bashkëpunimit rajonal, me synim nxitjen e projekteve të përbashkëta dhe zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik mes këtyre vendeve. Janë bërë udhëtime në Europë dhe jashtë kontinentit evropian në kuadër të intensifikimit të kontakteve mes parlamenteve të vendeve të ndryshme, me synim nxitjen e mëtejshme të diplomacisë parlamentare dhe forcimin e bashkëpunimit ndërparlamentar.

Shpenzime për pritje-përcjellje

Në zbatim të ceremonialit zyrtar dhe kuadrit ligjor në fuqi, buxheti i Kuvendit parashikon shpenzime për pritje-përcjellje të delegacioneve të huaja. Nga analiza e trendit të tre vjetve të fundit vihet re se ka rënie të këtyre shpenzimeve.

Shpenzimet e tjera operative që i përkasin programit administrativ

Në programin administrativ realizimi në masën 79% për shpenzimet operative ka ardhur si rezultat i kursimeve nga procedurat e prokurimit, nga anulimi i herëpashershëm i procedurave të prokurimit për shkak të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në dokumentacionin përkatës të prokurimeve nga ana e operatorëve ekonomikë si dhe realizimi i kontratave të shërbimeve në afate më të shkurtra kohore.

Gjatë muajit shkurt 2016 u mbyll me sukses Asambleja Parlamentare e Mesdheut, shpenzimet për të cilën ishin ndarë në zëra të veçantë, si: logjistika e nevojshme për organizimin e konferencës, akomodimi i delegacioneve pjesëmarrëse në hotel, pritja dhe përcjellja e tyre, marrje automjetesh me qira për sigurimin e transportit, dhe është vlerësuar paraprakisht në 12,4 milionë lekë. Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, si rezultat i konkurrencës, ky aktivitet me mbi 200 pjesëmarrës u realizua me rreth 8,1 milionë lekë, pra 70% e fondit të kërkuar. Njëkohësisht gjatë muajit maj 2016 u mbyll me sukses edhe Sesioni i Pranverës i Asamblesë Parlamentare të NATOS-s, shpenzimet për të cilin, sikundër Asambleja Parlamentare e Mesdheut, ishin të ndara në zëra të veçantë sipas nevojës së organizimit të konferencës. Parashikimi për realizimin e kësaj konference ishte 59 milionë lekë, u realizua me rreth 45,5 milionë lekë, pra 76% e fondit të kërkuar. Si pasojë e kursimeve nga tenderimet dhe procedurave të prokurimit, pjesa e mbetur nga fondi i parashikuar është kthyer në buxhetin e shtetit.

Duke pasur parasysh dhe disa shërbime të tjera, si ai i telefonisë celulare, shërbimi i mirëmbajtjes *E-parlament*, shërbime mirëmbajtjeje për fotokopje, autovetura etj., të cilat janë kursyer gjatë procedurave të prokurimit, por dhe janë shkurtuar në fondet limit për shkak të periudhës së shërbimit që do të mbulohej, Kuvendi ka bërë kthime në buxhet sipas akteve normative.

Nga analiza e shpenzimeve utilitare rezulton se fondi i parashikuar për shpenzimet e energjisë, ujit



dhe telefonisë për vitin 2016 është 11,500,000 lekë dhe është realizuar 10,804,157 lekë, pra në masën 94%. Trendi i konsumit nga viti në vit është pothuajse i pandryshueshëm.

Shpenzimet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore

Nga ky grup janë planifikuar fonde buxhetore në të dyja programet.

Në programin legjislativ janë ekzekutuar vendime gjyqësore ndaj kreditorëve ish-deputetë të legjislaturës paraardhëse dhe objekti është pothuaj i njëjtë: dhënia e pagës së munguar për periudhat shtator 2009–maj 2010 së bashku me kompensimet financiare që u njeh statusi i deputetit.

Nga ky grup, duke ndjekur radhën e kërkesave për ekzekutim, janë realizuar 87% të planifikimit.

Në programin administrativ janë ekzekutuar vendime gjyqësore me kreditorë ish-punonjës të Kuvendit. Realizimi faktik i këtij fondi është 92,3%.

Vlen të theksohet se për detyrime kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që u përkasin periudhave para vitit 2012, ISSH-ja ka dhënë si zgjidhje transferimin direkt në llogarinë e ISSH-së të kontributeve, duke përcjellë dhe listëpagesat sipas muajve dhe viteve si dhe kopje të vendimeve gjyqësore.

Investimet kapitale

Tabela e planit, ndryshimeve dhe realizimit faktik të investimeve për vitin 2016

Emërtimi	Plani fillestar	Rishperndarja (buxheti)	Nga fondi rezervë, me VKM nr.767 datë 2.11.2016	Plani i investimeve pas aktit normativ nr. 2	Realizimi faktik
Rikonstrukcion pjesor i godinës ekzistuese	24.800.000	19.000.000		19.000.000	17.550.225
Blerje pajisjesh për Kuvendin	4.900.000	3.400.000		3.400.000	3.001.886
Përmirësim i infrastrukturës network	15.000.000	14.230.000		14.230.000	14.223.480
Fond libri	700.000	600.000		600.000	592.690
Komunikim i telefonisë fikse	10.600.000	0		0	0
Kondicioner i precizionit të lartë (serverat)	3.000.000	3.000.000		3.000.000	2.868.000
Sistem votimi elektronik për vetting-un	0	18.770.000		0	0
Sistem votimi elektronik për vetting-un	0		2.372.097	0	0
	59.000.000	59.000.000	2.372.097	40.230.000	38.236.281



Siç shihet dhe nga tabela, investimet janë realizuar në masën 95% ndaj planit të ndryshuar.

Veçori e vitit 2016 është se administratat e Kuvendit, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i lindi nevoja e rivlerësimit të prioritetëve për investimet, me qëllim sigurimin e fondeve për realizimin e sistemit elektronik të votimit për *vetting*-un. Për këtë u komunikua zyrtarisht me Ministrinë e Financave për të rishpërndarë fondin prej 1 877 000 lekësh dhe siguruar nga fondi rezervë vlerën prej 2 372 097 lekë. Kjo rishpërndarje i përket heqjes dorë nga projekti për dixhitalizimin e telefonisë fikse dhe kursimeve në procedurat e prokurimit.

Çdo rivlerësim i prioritetëve, çdo vendimmarrje për shtesë fondi, për vlerësimin e fondit limit të sistemit e deri në kthimin në buxhet të këtyre fondeve si rezultat i vendimin nr. 69, datë 25.10.2016 të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka vendosur pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 84/2016, është bërë në bashkëpunim me Sekretariatën për Buxhetin dhe Byronë e Kuvendit në rolin e GMS-së (*Grupi për Menaxhimin Strategjik*) në institucion.

Projektet e investimeve janë marrë në dorëzim nga grupet e punës, të cilat kanë verifikuar përputhshmërinë me specifikimet e kërkuara, sasinë, cilësinë etj. Në pagesat e faturave është mbajtur 5% për garanci cilësie. Kjo vlerë është transferuar në llogarinë e buxhetit të shtetit “mjete monetare në ruajtje”.

Menaxhimi i aktiveve në institucion

Shërbimi i Financës, në zbatim të ligjit për kontabilitetin, ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit nr. 30 të ministrit të Financave, datë 27.12.2011, ka inicuar fillimin e procesit të inventarizimit të aktiveve në përdorim të punonjësve dhe të materialeve në magazina, për të vazhduar më pas me procesin e vlerësimit të aktiveve që vlerësohen jashtë funksionit, përdorimit dhe tjetërsimit të tyre (xjerrjes jashtë përdorimit).

2. Prokurimet

Menjëherë pas miratimit të buxhetit të shtetit për vitin 2016, në zbatim të rregullave të prokurimit publik, bazuar në ligjilacionin në fuqi Shërbimi i Prokurimeve në bashkëpunim me shërbimet e tjera të Kuvendit përgatiti regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2016. Ky regjistër u dërgua për botim në Agjencinë e Prokurimit Publik sipas afateve të përcaktuara në legjislacion. Gjithashtu një kopje iu dërgua Ministrisë së Financave dhe një kopje Degës së Thesarit.

Pas botimit të regjistrit të parashikimeve nga Agjencia e Prokurimit Publik, Shërbimi i Prokurimeve në bashkëpunim me drejtoritë e linjës filloi punën për plotësimin e dokumentacionit për shpalljen e procedurave.

Të gjitha procedurat standarde të prokurimit u zhvilluan me mjete elektronike nëpërmjet sistemit *on-line* të Agjensisë së Prokurimit Publik.

Gjatë vitit 2016 në Kuvendin e Shqipërisë janë shpallur gjithsej 21 procedura prokurimi me blerje të mëdha dhe 58 procedura me blerje të vogla. Blerja e biletave të transportit jashtë vendit është bërë në zbatim të marrëveshjes kuadër nga janari deri më 15 nëntor dhe me procedurë me negociim/procedurë me blerje të vogël, gjithsej janë lidhur 110 minikontrata.

Fondi limit i parashikuar për procedura me blerje të mëdha ka qenë 119 299 841 lekë, nga të cilat 31 334 966 lekë ishin fonde investimesh dhe 87 964 875 lekë ishin procedura me fondet e shpenzimeve operative.

Me fondet e investimeve nga 14 proceduara të parashikuara në regjistër u realizuan 8 procedura prokurimi, nga të cilat 4 procedura me blerje të mëdha dhe 4 procedura me blerje të vogla.



Me fondet e shpenzimeve operative u realizuan 53 procedura prokurimi, nga të cilat 17 janë procedura me blerje të mëdha dhe 36 janë procedura me blerje të vogla. Si rezultat i konkurrencës, u arrit që në përfundim të procedurave të kishte një efekt ekonomik pozitiv ndaj fondit limit.

Të gjitha procedurat e prokurimit të planifikuara për vitin 2016 përfunduan brenda afatit të përcaktuar në rregullat e prokurimit, pra para datës 31 dhjetor.

3. Transporti

Shërbimi i Transportit është angazhuar për përmbushjen sa më mirë të objektivave dhe detyrave të përcaktuara, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Për t'i ofruar institucionit shërbime transporti cilësore dhe në kohën e duhur, u hartua plani vjetor i shpenzimeve për këtë Shërbim për vitin 2016, duke bërë dhe ndarjen në zëra të veçantë.

Është siguruar gadishmëria teknike e autovecurave në dispozicion të Kryesisë së Kuvendit në nivele optimale, duke garantuar një shërbim në kohë dhe me cilësinë e duhur për lëvizjet brenda dhe jashtë vendit. Është planifikuar dhe organizuar lëvizja e delegacioneve parlamentare shqiptare dhe stafit të Kuvendit jashtë shtetit.

Në bashkëpunim me Shërbimin e Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputeteve është planifikuar dhe organizuar lëvizja e punonjësve në zyrat e deputetëve në të gjitha qarqet e vendit, duke kryer disa ture lëvizjesh.

U ndoq me prioritet organizimi dhe menaxhimi i pritjes së delegacioneve të Asamblesë Parlamentare të NATO-s dhe të Asamblesë Parlamentare të Mesdheut.

4. Mirëmbajtja

Në vlerësim të nevojave, me qëllim krijimin e kushteve sa më të mira për kryerjen e veprimtarisë institucionale dhe në përmbushje të detyrës funksionale, Drejtoria e Mirëmbajtjes ka analizuar nevojat, ka kordinuar dhe mbikëqyrur realizimin e një sërë projektsh të realizuara gjatë vitit 2016, ku vlen të përmendet rikonstruksioni i ambienteve të Kryesisë së Kuvendit (tualet, lagështira, rrufepritës) F.V. kondicioner i precizionit të lartë, mirëmbajtje, shërbim i motogjeratorit TIP C550 DS, mirëmbajtje kondicionerësh 12–24 BTU etj. Gjithashtu ka përfunduar rikonstruksionin e kabinës elektrike 20 KW dhe 6 KW, si kërkesë e domosdoshme për shkak të historikut të hershëm të ekzistencës së saj që nga vitet '60. Po kështu në koordinim të kërkesave të drejtorive ka përmbushur nevojat për materiale kancelarie, elektrike, higjienosanitare për mirëfunksionimin dhe përmirësimin e punës në institucion. Drejtoria e Mirëmbajtjes ka ndjekur me korrektësi marrëdhëniet me OSSHE-në, Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve, duke siguruar normalitet në veprimtarinë institucionale dhe shmangur problematikat e rastit. Në mënyrë të vazhdueshme rrit kërkesën e llogarisë për përmirësimin e nivelit higjienosanitar dhe krijimin e kushteve sa më të mira të punës.

5. Shërbime të tjera administrative

Burimet Njerëzore

Gjatë vitit 2016 (periudha janar–dhjetor) Shërbimi ka ndjekur dhe realizuar detyrat dhe objektivat si më poshtë:

1. Plani i pranimeve të reja:

Në zbatim të vendimit nr. 5, datë 11.02.2016, “Plani vjetor i pranimeve në Shërbimin Civil të



Kuvendit për vitin 2016”, është realizuar si më poshtë:

1. Niveli i lartë drejtues - 3 (tre) drejtorë
2. Niveli i mesëm drejtues - 4 (katër) drejtorë
3. Niveli i mesëm drejtues - 5 (pesë) këshilltarë;
4. Shef sektori - 2 (dy);
5. Niveli ekzekutiv – 13 (trembëdhjetë) specialistë.

2. Në zbatim të planit të punonjësve të përkohshëm me kontratë, të miratuar me VKM nr. 11, datë 20.01.2016, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2016 në njësitë e qeverisjes qendrore”, u kontraktuan 10 punonjës sipas kërkesave specifike të shërbimeve.

Në vitin 2016 kanë dalë në pension 5 punonjës dhe janë larguar nga Kuvendi 12 punonjës. Me masë disiplinore është larguar vetëm një punonjës.

3. Deklarimi i pasurisë

Në zbatimin e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, është bërë brenda afateve ligjore deklarimi i pasurisë nga punonjësit dhe deputetët që mbartin detyrimin.

Gjatë vitit 2016 kemi pasur 11 (njëmbëdhjetë) subjekte që kanë bërë deklarim për herë të parë, nga të cilët: 2 deputetë dhe 9 nëpunës.

Në këtë periudhë katër deputetë kanë lënë mandatin, një deputet kandidoi në zgjedhjet e pushtetit vendor dhe tre deputetëve të tjerë u është hequr mandati.

Në vitin 2016 kanë bërë deklarim pas largimit 11 (njëmbëdhjetë) subjekte, nga të cilat:

- 4 deputetë;
- 7 nëpunës

Gjithashtu janë dhe 3 (tre) nëpunës të pezulluar që kanë detyrimin e deklarimit periodik vjetor.

Për vitin 2016 subjekte deklaruese periodike vjetore janë gjithsej 207, nga të cilat:

- 136 deputetë;
- 71 nëpunës

Për sa i përket procesit të vetëdeklarimit pranë DAP-it në kuadër të ligjit për dekriminalizimin të gjithë nëpunësit civilë që kanë pasur detyrimin për të plotësuar formularin e kanë dorëzuar pranë DAP-it në afatin e kërkuar.

Bazuar në vendimin e Byrosë së Kuvendit nr. 19, datë 11.11.2014 “Për hapjen e zyrave për deputetët e Kuvendit në 12 qarqe” dhe vendimin nr. 22, datë 2.02.2015 “Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën e administratës së Kuvendit”, kanë funksionuar 10 zyra në 5 qarqe, përkatësisht: Fier, Gjirokastrë, Kukës, Korçë dhe Shkodër. Është marrë miratimi edhe për dy zyra në qarkun e Vlorës. Numri i planifikuar nuk është realizuar për mungesë të bashkëpunimit të pushtetit vendor për sigurimin e ambienteve të punës.

6. Arkivi

Gjatë vitit kalendarik 2016 Sektori i Arkivit ka vazhduar të përmbushë objektivat në punën e tij bazuar në detyrat e përcaktuara në *Manualin e përshkrimit të punëve të administratës së Kuvendit* si dhe në përputhje me Rregulloren “Për administrimin e dokumentacionit parlamentar dhe funksionimin e Arkivit të Dokumentacionit Parlamentar”.



Drejtimet kryesore të punës së Zyrës së Arkivit gjatë vitit 2016 kanë qenë:

Mbledhja dhe përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve

Spektori i Arkivit ka mbledhur, përpunuar dhe administruar dokumentacionin parlamentar dhe administrativ për vitet 2015 dhe 2016.

Krahas verifikimit dhe marrjes përfundimtare në dorëzim nga Zyra e Protokollit (qershor 2016) të të gjithë dokumentacionit të krijuar gjatë veprimtarisë parlamentare dhe administrative të Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2015, Zyra e Arkivit realizoi fillimisht ndarjen përfundimtare të fondit të përhershëm dhe të përkohshëm të vitit në fjalë. Më pas u kalua në përpunimin e fondit me afat ruajtjeje të përhershëm, duke automatizuar dhe ngritur inventarin përkatës:

Inventar i përhershëm 25/2015 - në proces (630 dosje/njësi vëllimore). Këto dosje me rëndësi historike kombëtare (RHK) gjenden të klasifikuara dhe të përpunuara automatikisht në bazën e të dhënave për vitin 2015. Pjesë e këtij fondi janë edhe 57 DVD të regjistrimit të seancave plenare për vitin 2015.

Inventar i përkohshëm 25/2015 - në proces

- Me qëllim riformatimin dhe rishikimin e fondit arkivor në vite, ka vijuar puna në retrospektivë për fondet e atyre viteve që kërkojnë bërjen e shtesave brenda inventarëve të tyre përkatës, duke riklasifikuar dosjet ekzistuese dhe ato të reja dhe duke i unifikuar ato me bazën e përgjithshme të të dhënave të fondit arkivor të Kuvendit.

Inventar i përhershëm 1/1993 - 360 dosje

Inventar i përhershëm 2/1994 - në proces

- Ka vijuar puna për dorëzimin korrent të dokumentacionit parlamentar për vitin 2016. Për periudhën janar–dhjetor 2016 janë marrë në dorëzim dhe përpunuar fizikisht rreth 268 dosje me afat të përhershëm, dokumentacion ky që u përket akteve të miratuara në seancat plenare të vitit në fjalë:

- ligje, të shoqëruara me praktikën përkatëse (projekte, raporte dhe procesverbale të komisioneve, fletëvotimet, amendamentet, dekretet etj.);

- vendime të Kuvendit, të shoqëruara me praktikën përkatëse (projekte, raporte dhe procesverbale të komisioneve, fletëvotimet, amendamentet etj.);

- rezoluta të Kuvendit, të shoqëruara me praktikën përkatëse (projekte, raporte dhe procesverbale të komisioneve, fletëvotime etj.);

- procesverbale të seancave plenare.

- Ndërkohë është marrë në dorëzim nga shërbimet përkatëse dokumentacioni parlamentar që i përket veprimtarisë së Konferencës së Kryetarëve, Byrosë, këshillave parlamentarë, komisioneve parlamentare si dhe ato që pasqyrojnë marrëdhëniet ndërparlamentare të Kryetarit të Kuvendit.

- Si pasojë e aktivizimit të punonjësit të arkivit/protokollit (me kontratë) në Sektorin e Arkivit, me qëllim inventarizimin dhe arkivimin e letrave të popullit për vitet 1991–2012, është përpunuar dhe klasifikuar i gjithë fondi arkivor i letrave të popullit për periudhën në fjalë.

- Me hartimin e listës së dokumenteve me afatet e ruajtjes, veç për dokumentet me rëndësi historike kombëtare me afat ruajtjeje të përhershme (nëse ka) dhe veç për ato me vlerë ruajtjeje të përkohshme, janë ngritur inventarët përkatës të çdo viti, nga ku në total rezultojnë 1286 dosje të përfunduara.



- Si pasojë e aktivizimit të një punonjësi (me kontratë) në Sektorin e Arkivit për skanimin e dokumentacionit parlamentar për vitet 1991–2013 procesi i punës ka vijuar me skanimin, ruajtjen, emërimin dhe klasifikimin e dokumenteve parlamentare, si pjesë përbërëse e çdo akti të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Aktualisht janë skanuar gjithsej **50 000 fletë**, që i përkasin fondit arkivor me afat ruajtje të përhershëm për vitin 2011–2013.

- Sektori i Arkivit ka marrë në dorëzim dokumentet e klasifikuara nga zyra e Kuvendit për Informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”. Në zbatim të ligjit nr. 8457, dt. 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” dhe akteve nënligjore përkatëse të miratuara nga Këshilli i Ministrave, Sektori i Arkivit ka përpunuar dokumentacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” për periudhën e viteve 1991–2005, i cili do t’i nënshtrohet gjatë vitit në vazhdim procesit të ekspertizës.

Shfrytëzimi i materialit arkivor

Zyra e Arkivit gjatë vitit 2016 ka ofruar shërbimin e saj për realizimin në kohë dhe me efikasitet të rreth **415 kërkesave** të ardhura nga shërbimet e administratës së Kuvendit, institucionet shtetërore dhe individë të veçantë. Edhe gjatë këtij viti vihet re një rritje e ndjeshme e kërkesave që i janë drejtuar Sektorit të Arkivit, të cilat janë realizuar nëpërmjet konsultimit apo riprodhimit të tyre në sallën e shfrytëzimit, por edhe nëpërmjet komunikimeve telefonike dhe elektronike.

Shërbimi i ofruar është kryer nëpërmjet:

- shërbimit të dokumenteve ose riprodhimeve të tyre;
- vënies në dispozicion të përmbledhjeve me dokumente, inventarëve apo bibliografive tematike për çështje të caktuara;
- dhënies së informacionit dhe burimeve të tij për problemet që u kanë interesuar personave kërkuar.

Ekspertiza e vlerës së ruajtjes të dokumenteve

Bazuar në kriteret themelore të ekspertizës së vlerës së ruajtjes të përcaktuara në udhëzimet metodike përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Sektori i Arkivit ka ndjekur procesin për ngritjen e Komisionit të Ekspertizës, i cili shqyrtoi dhe miratoi listën e dokumenteve konkrete me afatet e ruajtjes, si dhe listat e veçimit për asgjësim të dokumenteve që kanë plotësuar afatin e ruajtjes.

Në këtë kuadër, Sektori i Arkivit ka përfunduar punën për shqyrtimin e listave të veçimit:

- nr. 1/1 (inventari fizik i letrave të popullit për vitin 1991);
- nr. 2/1 (inventari fizik i letrave të popullit për vitin 1992);
- nr. 3/1 (inventari fizik i letrave të popullit për vitin 1993);
- nr. 4/1 (inventari fizik i letrave të popullit për vitin 1994);
- nr. 5 (inventari fizik për vitin 1995);
- nr. 5/1 (inventari fizik i letrave të popullit për vitin 1995).



Përfundime

Nga raportimi vjetor i punës së Kuvendit të Shqipërisë rezulton zhvillimi konstant dhe i qëndrueshëm në drejtim të:

a) Forcimit të funksionit ligjvënës të Kuvendit, të rolit mbikëqyrës së tij si dhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit dhe të monitorimit të institucioneve të pavarura.

b) Veprimit me efikasitet për shqyrtimin e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së, me qëllim garantimin e një përafrimi më efektiv dhe cilësi më të mirë. Po ashtu një punë e mirë është bërë në drejtim të forcimit të rolit mbikëqyrës dhe të ndërveprimit të Kuvendit me institucionet e pavarura për garantimin e pavarësisë, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së tyre.

c) rritjes së perceptimit të publikut për një parlament pranë dhe në kontakt me qytetarin, si dhe për një institucion plotësisht të hapur dhe transparent, i cili ofron informacionin e nevojshëm mbi rolin dhe veprimtarinë e tij në proceset zhvilluese dhe integruese të vendit.

d) zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative dhe të ekspertizës në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me forcimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, garantimin e transparencës parlamentare si dhe me procesin e integritetit evropian.

Objektivat e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2017 do të jenë:

a) forcimi i funksionit ligjvënës;

b) forcimi i rolit mbikëqyrës përmes përdorimit më intensiv të instrumenteve të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit;

c) nxitja e mëtejshme të diplomacisë parlamentare përmes intensifikimit dhe forcimit të kontakteve dhe shkëmbimeve me parlamente të vendeve të tjera, si dhe përmes pjesëmarrjes në sesione parlamentare dhe takime të tjera të organizatave ku Shqipëria është palë;

ç) forcimi i kapaciteteve të Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian, me qëllim që ky institucion të përmbushë plotësisht rolin e tij si forum për përfshirje të gjerë dhe konsultime për çështjet e integritetit evropian;

d) forcimi i transparencës parlamentare;

e) forcimi i kapaciteteve të Kuvendit për shqyrtimin e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së për të garantuar një përafrim më efektiv dhe cilësi më të mirë të legjislacionit;

f) forcimi i kapaciteteve administrative dhe të burimeve njerëzore.

